ExLibris

E PËRJAVSHME LETRARE KULTURORE

çdo të shtunë

Themelues • Kryeredaktor BUJAR HUDHRI

E SHTUNË, 16 MAJ 2020. NUMËR 79. VITI II I BOTIMIT. ÇMIMI 50 LEKË. WWW.EXLIBRIS.AL EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL BOTIM I ONUFRI SHPK

Pastori ungjillor David Hosaflook, tregon përvojën e çmuar për përkthimin në anglisht, pas 500 vjetësh, të veprës së rëndësishme të Marin Barletit "Rrethimi i Shkodrës", duke u nisur nga përkthimi prej latinishtes së Henrik Lacajt.

DAVID HOSAFLOOK:

Gjuha shqipe më shërbeu si ndëmjetëse midis latinishtes dhe anglishtes

ZIJA ÇELA – BUKA E GRUNJTË E LETËRSISË

nga Xhevair Lleshi

Kam dashur gjithnjë ta kisha mik, të ma nderonte odën time të letërsisë. Dikur isha me të për një kafe, tek *Taivani*, jashtë në gjysmëhijen e tronditur nga zhegu i korrikut...

(fq. 5)



"EKLIPS" SI PARATEKST I ROMANIT "OH"

nga Behar Gjoka

Dëshmi e shkrimit me dy zhanre dhe variante gjuhësore, si dhe me dy versione letrare, është rasti i romanit *OH* që, në fakt, është një bartje e situatës estetike me realitetin e prozës *Eklips*...

(fq. 8)

"Udhëzime për kapërcimin e detit"

parathënie për botimit e tretë

Nga Mehmet Kraja

(fq. 15)

KUJTESA NË STRUKTURËN ROMANORE TË I. KADARESË: "DOSJA H." dhe "PËRBINDËSHI"

nga Lili Sula

(fq. 16)

TREGIME

Bajram Sefaj: *Beso* *(fq. 9)*

Liridon Mulaj: *Kujtimet e Katerinës* *(fq. 11)*

POEZI

Sali Bashota: *Zemërimi i botës* *(fq. 13)*

VEXHI BUHARAJA, PA MITE E MJEGULL

nga Yzedin Hima

(fq. 6)

MO YAN

DUKE DËGJUAR "KUAKJEN E BRETKOSAVE"

(fq. 14)

John Updike

RËNDËSIA E SHKRIMËSISË

NUK IA KEMI QITUR PIKËN

Ese nga Rexhep Ferri

(fq. 10)

Pastori ungjillor David Hosaflook, tregon përvojën e çmuar për përkthimin në anglisht, pas 500 vjetësh, të veprës së rëndësishme të Marin Barletit "Rrethimi i Shkodrës", duke u nisur nga përkthimi prej latinishtes së Henrik Lacajt.

David Hosaflook

Gjuha shqipe më shërbeu si ndëmjetëse midis latinishtes dhe anglishtes

Tashmë David Hosaflook dhe familja kanë marrë nënshtetësinë shqiptare. A mund të kthehemi tridhjetë vjet më parë kur erdhët në Shqipëri? Atëherë ishit një djalosh njëzetvjeçar.

Gjatë historisë, udhëtarët dhe udhëpërshkruesit e huaj kanë fituar një simpati të veçantë për Shqipërinë dhe shqiptarët... William Martin Leake, Lord Byron, Edward Lear, Johann Georg von Hahn, Emily Strangford, Rose Wilder Lane etj. Edith Durham-i, për shembull, ka pasur një qëndrim të ftohtë ndaj shqiptarëve para se të vinte dhe para se t'u binte kryq e tërthor viseve shqiptare. Pastaj u bë "mbretëreshë" e maleve tona, duke lutur dhe duke këshilluar Princ Vidin që të mos rrinte në pallatin e tij në Durrës, i paralizuar nga intrigat, por të udhëtonte e të takonte shqiptarët rreth sofrave të tyre. Vidi nuk e pranoi kurrë këshillën e saj dhe, kështu, ka mbetur pothuajse i harruar në historinë e shqiptarëve.



Këto gjëra nuk i dija kur erdha këtu në vitin 1992. Erdha si besimtar, i shtyrë nga "amaneti" i Jezusit, kur u tha ndjekësve të tij: "Shkoni në mbarë botën dhe predikoni Ungjillin." Shqipëria gëzonte një reputacion të rrallë në botë, si vendi i vetëm ateist. Ishte "Koreja e Veriut" e Europës. Kjo më tërhoqi. Zbulova se shqiptarët, pas gjithë atyre viteve të trushpëlarjes, nëpërmjet librave, si *Shkenca dhe feja janë të papajtueshme* apo *Rreziku anglo-amerikan për Shqipërinë*, nuk ishin të bindur për vlerat e ateizmit, e sigurisht nuk kishin gjetur as paqe, as parajsë. Kishin ende pyetje për jetën, vdekjen, e jetën pas vdekjes. Një ndër takimet e mia të para me "publikun e gjerë" ishte një emision javor në Radio Shkodra, me gazetarin Lek Plani, ku kam mbrojtur shkencërisht krijimin e njeriut nga Perëndia, në kundërshtim të teorisë së pavërtetuar të makroevolucionit. Ende besoj se shqiptarët duhet të kërkojnë Zotin, me zemër, jo me fjalë. Ai është zgjidhja dhe jeta, por ai kërkon pendim.

Shpejt, në vitet 1990, kam përjetuar të njëjtën forcë magnetike që shqiptarët kanë ushtruar mbi udhëtarët e mëparshëm të huaj: ngrohtësia e tyre, mikpritja, trimëria dhe respekti. Ne shqiptarët (po, jam edhe unë shqiptar tani) kemi edhe të meta, shumë madje, jemi shumë enigmatikë. Gjendja e Shqipërisë në vitin 1992 ishte çfarë ishte, por kam mësuar së shpejti kuptimin e shprehjes "bukë, kripë e zemër". Meqë kam jetuar në Shqipëri më shumë se në vendin tim të lindjes, e mora nënshtetësinë, me gjithë familjen time. Jam krenar që jam shqiptar.

Gjuha shqipe që flisni dhe shkruani është e mahnitshme. Si e mësuat gjuhën tonë?

Me shumë lot... por faleminderit për komplimentin. Ende po përpiqem ta mësoj, e më vjen keq që kanë hyrë kaq shumë huazime. Sa do të doja të ktheheshin fjalë të përdorura në kohën e Rilindjes, si p.sh. *bashkëfolje* për dialogë, *dhéshëtitës* për eksplorator etj.

Më keni treguar se si, rastësisht, në një trotuar në Shkodër ju kapi syri një libër me titullin "Rrethimi i Shkodrës". Me siguri kjo vepër e rëndësishme e kulturës sonë do t'ju lidhte më shumë me Shqipërinë.

Miku im, dikur profesori im i gjuhës, prof. Nuri Gokaj, më kishte dhënë një porosi, të përktheja në anglisht disa rreshta nga letërsia shqipe. Kur pashë imazhin e kështjellës së Rozafës në kopertinën e librit, u tërhoqa fort, se e dua atë kala, është vendi im më i preferuar në botë. Si mund ta dija se bashkëfolja ime e shkurtër me librashitësin atë ditë do të ndryshonte jetën time?! Sa mora vesh ç'kishte ndodhur pranë mureve të Rozafës, pra që kishte ardhur personalisht në Shkodër Mehmet sulltani, pushtuesi i Kostandinopojës, kuptova rëndësinë strategjike të Shkodrës në përballjet mes Lindjes dhe Perëndimit.

"Rrethimi i Shkodrës", çuditërisht, nuk ishte në anglisht. Ju e konstatuat këtë dhe filluat me përkthimin. Dua ta përmend me gëzim një fakt: ju përkthyet në anglisht këtë libër duke u nisur nga shqipja e latinistit të shquar, Henrik Lacaj. Pra, shqipja shërbeu si një gjuhë ndërmjetëse, midis latinishtes, gjuhës së kulturës europiane, dhe anglishtes, tashmë gjuhë botërore. A fitoi më shumë varianti anglisht nga ky?

Historia mahnitëse dhe letërsia rrëqethëse e Marin Barlecit më la pa fjalë. Meqë ende nuk po kuptoja mirë gjuhën shqipe, kërkova variantin anglisht. *Sigurisht ekziston*, - thashë me vete. Por



jo! Atëherë nisa ta përktheja, jo për ta botuar, por më tepër që të kuptoja më mirë se ç'kishte ndodhur në qytetin tim të ri. Jam i vetëdijshëm se përkthimi nga origjinali është gjithmonë zgjidhja më e mirë, por kishim pritur më shumë se 500 vjet dhe askush nuk kishte marrë përsipër ta përkthente në anglisht nga latinishtja. Ndaj, bota anglishtfolëse i mbetet borxhli Henrik Lacajt. Barleti ishte shkodran i cili ka shkruar latinisht. Kur shkruaj unë, për shembull, në gjuhën shqipe, nuk mund të mos dalë brumosja ime amerikane, qoftë në përmbajtje, qoftë edhe në stil. Jam i bindur që latinishtja e Barletit është e tillë. Lacaj, shkodran si Barleti, arriti të futej brenda kokës së autorit, ndaj teksti shqip nuk është vetëm i shqipëruar, por edhe i barletizuar. Pastaj unë, si amerikan i shkodranizuar, kam arritur, shpresoj, të tejçoj këtë zinxhir, me besnikëri dhe bukuri.

Përkushtimi juaj për të botuar në anglisht librin "Rrethimi i Shkodrës" ishte një fat i madh për variantin shqip që ribotuam në qindvjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë. A mund të na flisni më hollësisht se sa kohë u desh ta përfundonit dhe cilat burime të tjera, të panjohura deri atë kohë nga historianët shqiptarë, shërbyen që ky libër të ishte sa më i plotë dhe dinjitoz për shekullin XXI?

U afrova pranë shtëpisë botuese "Onufri" me kërkesën që ta botonte variantin anglisht, meqë kisha një përshtypje të mirë për seriozitetin e saj. Më priti botuesi në zyrën e tij, tepër modest, dhe më tregoi se, prej kohësh, ata kishin pasur një dëshirë të ribotonin variantin shqip, jo në mënyrë të piratuar (siç gjendet ende sot nëpër dyqane, me gabime dhe pa asnjë leje nga familja Lacaj), por në mënyrë dinjitoze nga ana ligjore, etike dhe cilësore. "Pse të mos bashkëpunojmë, - më tha botuesi, - që të dalin të dyja variantet njëkohësisht?" Sa u gëzova, se le të mos harrojmë që *Rrethimi i Shkodrës* është libri i parë që njihet të jetë shkruar nga një shqiptar. Sa i rëndësishëm që të ribotohet! Aty në zyrën e vogël të drejtorit filloi një bashkëpunim serioz dhe që do ta çmoj përjetë. Për kohën e përgatitjes, mjafton të them se jam marrë me përkthimin e librit prej vitit 1995 deri në vitin 2012. Është më tepër se një përkthim. Libri është pasuruar me shtojca, parathënie nga historianë, si Aleks Buda dhe David Abulafia, përmban edhe kronikat osmane të rrethimit, shënime historike dhe një bibliografi prej 136 burimesh që kam shfrytëzuar, të gjithë këto iu shtuan variantit shqip, duke shndërruar librin në një tekst historie, po aq sa është një vepër letrare.

Pas kaq kohësh që libri shitet për lexuesin anglishtfolës, a mund të na flisni për jehonën që ka pasur në rrethet akademike dhe jo vetëm?

Jam shumë i gëzuar që në qarqe akademike, historianë me emër paskan mirëpritur librin si një hallkë që kishte munguar në historinë e Mesdheut dhe kanë filluar ta citojnë në trajtesat shkencore të periudhës. Mund të përmend emra, si historiani David Abulafia (profesor në Universitetin Cambridge), autori Roger Crowley, i ndjeri albanolog Robert Elsie, i ndjeri historian Halil Inalcik i Turqisë etj. Ende nuk jam i kënaqur me nivelin e trajtimit të librit në viset shqiptare, sepse për mendimin tim ky libër duhet studiuar më gjerësisht në fakultetet e historisë dhe të letërsisë, pse jo edhe në shkolla të mesme. Ismail Kadare ka shkruar parathënien e botimit të ri, duke e quajtur këtë libër "kryeveprën" e Barletit, një libër monumental. Çfarë mund t'i shtojmë fjalës së Kadaresë?

Me siguri, pas përkthimit të këtij libri, keni pasur kërkesa për të përkthyer edhe libra të tjerë, sidomos letërsi artistike, meqenëse përkthyes të zotë nga shqipja në anglisht ka fare pak. Si u përgjigjeni në këto raste?

Në kafen time të fundit me Robert Elsie në sheshin *Skënderbej*, ai më tha: "Ju paralajmëroj, David, do t'ju vijnë shumë kërkesa, sepse jemi shumë pak veta që mund të përkthejmë siç duhet nga shqipja në anglisht." Profetizimi i tij u realizua, por me keqardhje zakonisht duhet të them "jo". Nuk jam një përkthyes në profesion. Nuk kam kohë. Kam shumë përgjegjësi të tjera në familje, në kisha, në institutin që drejtoj dhe në universitete ku jap mësim. Jam tepër i ngarkuar. Kam përkthyer *Rrethimin e Shkodrës* nga dëshira, pa pagesë. Qëndrimi im ka vetëm disa përjashtime, raste të rralla, kur një burim i historisë shqiptare më tërheq kaq shumë sa që shtrëngohem ta përkthej.

Ju keni një kontribut të çmuar për ndriçimin e trashëgimisë kulturore dhe arsimore të familjes Qiriazi. Qendra që ju drejtoni ka bërë shumë botime librash dhe veprimtari të tjera, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Maqedoninë e Veriut apo Kosovë. A i keni arritur pikësynimet tuaja tashmë?

Jam një ndër themeluesit dhe drejtori i Institutit për Studime Shqiptare dhe Protestante, i cili ka për mision të nxisë zbulimin e historisë dhe mendimit shqiptar dhe protestant. Shumica e shqiptarëve nuk dinë që ka pasur një komunitet zyrtar protestant shqiptar, që në vitin 1891, themeluar jo nga të huajt, por nga shqiptarët, me familjen Qiriazi në krye. Jam doktoruar para disa vjetësh në Universitetin e Tiranës, për histori, me këtë temë për disertacion. Normalisht, historia e ungjillorëve dhe botimet e tyre ishin fshehur gjatë diktaturës, por pasuria dokumentare është marramendëse. Kemi botuar deri tani 24 libra dhe kemi shumë të tjerë që duhet të dalin në dritë.

A mund të na flisni për familjen tuaj? A ndihen ata amerikano-shqiptarë?

Nuk e meritoj bashkëshorten time të mrekullueshme, shoqen e jetës, e cila pranoi të linte qytetin e saj të bukur, Orlandon, dhe familjen e saj, që të shërbente krahas meje në këtë vend. U martuam në vitin 1997 – vitin e famshëm – dhe e gjithë Shqipëria paska "festuar" dasmën tonë, me kallashnikovë! Kështu themi ne, së paku, se do pak humor në kohë krizash. Shkodra ka pasur shumë kriza gjatë viteve dhe ime shoqe ka përjetuar situata stresi, si gjithë nënat e reja shkodrane, por së bashku me to. Me gjithë këto vështirësi, ajo kurrë nuk më vuri nën presion për t'u kthyer në Amerikë. Këtë e vlerësoj shumë. Kemi pesë fëmijë, dy të birësuar nga jetimore shqiptare. Janë rritur këtu dhe, sigurisht, ndihen amerikano-shqiptarë.

Në këtë kohë izolimi për shkak të Covid 19, me çfarë merreni? A keni ndonjë projekt të ri?

Aktualisht, COVID-i më ka gjetur në Shqipëri, por familjen time në Amerikë. Ndaj fati im ka qenë të jem vetëm, por lavdi Zotit për teknologjinë, që na bashkon përditë me telefon. Gjatë kësaj kohe kam përkthyer në anglisht librin/ albumin e Ferid Hudhrit, *Shqipëria në art*. Ky libër, për mua, është një kryevepër nga ana pamore dhe intelektuale, një ekspozitë virtuale që çdo shqiptar jashtë atdheut duhet të mbajë, siç themi në Amerikë, si një "coffee table book" për odën e mysafirëve.

Së dyti, kam punuar për ribotimin e dy librave të Gjerasim dhe Gjergj Qiriazit, *Krestomaci, a udhëheqës për çdo shtëpi shqiptari, gjëra të ndryshme e të vlefshme për lexim në mësonjëtoret shqipe* (vëllimi I, 1902 dhe vëllimi II, 1907). Dr. Jorina Kryeziu ka transkriptuar këto vëllime (secili me nga 317 faqe!) në alfabetin e sotëm dhe po bashkëpunoj me një studiues të ri impresionues, z. Ledio Hala, për ballafaqimin e tekstit me origjinalin. Duke u marrë me disa faqe në ditë, shpresojmë që librat të dalin në vjeshtë.

Projekti më i vështirë gjatë kësaj kohe ka qenë organizimi i arkivit të Institutit tonë. Në vitin 2016 kemi marrë një fond arkivor, koleksionin e Edwin Jacques (shqiptohet *Xhejks*, jo *Xhak* si mendohet në Shqipëri, sepse ishte amerikan, jo francez). Xhejksi ka qenë misionar protestant në kishën ungjillore




Henrik Lacaj

të Korçës nga viti 1932 deri në vitin 1940, deri kur u dëbua për shkak të luftës. Sigurisht, regjimi nuk e lejoi të kthehej. Kështu, nga larg, Xhejksi i kushtoi gjithë jetën e tij studimit të historisë së shqiptarëve. Ai vetë kishte marrë koleksionin e dorëshkrimeve dhe shtypshkrimeve të misionarëve protestantë Phineas dhe Violeta Kennedy, të cilët kanë shërbyer në Korçë gjatë viteve 1908-1935, në shkollat shqipe dhe në kishat ungjillore. Xhejksi shquhet për librin e tij 750-faqësh, *The Albanians (Shqiptarët: historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme*), mundësisht libri më i madh për historinë e shqiptarëve në gjuhën angleze.

Pas vdekjes së Xhejksit, në vitin 1998, fëmijët e tij ia dhuruan koleksionin Seminarit Baptist të Denverit në SHBA. Kur e vizitova arkivin për herë të parë, në vitin 2014, u mahnita me sasinë dhe pasurinë e materialit (që nga viti 1908!) – dorëshkrime, kartolina, fotografi, botime etj., madje edhe artikuj të ndryshëm, si flamuj të vjetër shqiptarë të zverdhur dhe opinga prej gome. Ky burrë e deshi Shqipërinë po aq sa unë! Arkivistja e seminarit filloi të qeshte me mua, duke parë se si po "kërceja nga gëzimi" me çdo sirtar tjetër që po më tregonte. Më tha: "Këtu në Denver, aq larg Shqipërisë, askush nuk shfaq interes për këto gjëra! Ndaj po gëzohem." Historia është e gjatë, por me pak fjalë, në vitin 2016, me bekimin e fëmijëve të E. Xhejksit, arritëm ta merrnim arkivin, me qëllim që ta shfrytëzojnë studiuesit shqiptarë dhe albanologët e huaj.

Ky fond ka mijëra dokumente dhe, deri tani, nuk kemi pasur mundësi t'i sistemojmë. Puna në arkiva është punë murgu dhe COVID-i më bëri murg! Ndaj, gjatë kësaj kohe izolimi, kam punuar që në mëngjes deri në darkë për këtë punë. Arkivi Qendror i Shtetit na ka ndihmuar me dosje dhe kuti arkivore, e shpresojmë që në të ardhmen të skanojmë gjithçka e të ofrohet online për studiues. Bibla thotë se korrim atë që mbjellim, ndaj shpresoj që kjo kohë të sjellë shumë fryte në të ardhmen.

ZIJA ÇELA – BUKA E GRUNJTË E LETËRSISË

nga Xhevair Lleshi

Kam dashur gjithnjë ta kisha mik, të ma nderonte odën time të letërsisë. Dikur isha me të për një kafe, tek *Taivani*, jashtë në gjysmëhijen e tronditur nga zhegu i korrikut, diku afër dhe përtej parkut të vjetër, ndonjë pike uji që vinte nga shatërvani i tkurrur dhe kalimtarëve që mbanin në vend të kapelave nga një shami të lagur mbi kokë. Ne, sigurisht, miq ishim se të tillë na kishin bërë djemtë, dhimbja e thellë, si një dashuri e larguar prej boshtit të vet. Më dukej se ajo fole bisede qe bërë si një kasolle shtegtare vere pranë lumit të dhimbjes. Rrinte dhe më shihte plot afërì. Fjalët i buronin vetiu, duke ndërtuar aty për aty një metaforë të madhe, se ai të tilla vepra ndërton, vendos ardhacakë që i bëjnë shtëpitë shpejt e shpejt dhe me ç't'u dalë përpara, vijëzojnë një profil të ri jete kurrë të menduar. Gjen kështu në bisedë me të personazhe të veprës së tij të gjerë, me plot emra tronditës, përshkuar nga një dashuri ekstreme dhe e bashkëshoqëruar nga një dhembje fatale. Duket sikur ka hyrë në një labirint ku estetika, morali, mendimi dhe emocioni janë kapur përdore dhe vallëzojnë plot bujë duke shkundur tym e melodi, jetë para dhe pas Krishtit, para dhe pas Virusit... Këtu nëpër rreshtat e bisedave në korpusin gjigant të veprave të këtij burri të pakët por me mendje gjeniale, kalojnë perandorë të historisë, kalimtarë të rastit, fshatarë të lodhur e me djersën mpiksur mbi fytyrë, burra dhe gra qyteti që ndihen jashtëzakonisht të shqetësuar si nën një frustrim kamxhikësh e që ndihen nën një përndjekje të tmerrshme. Dhe kurdoherë aty pranë është Dritani, i biri, dhimbja therëse dhe ndjenja e jashtëzakonshme që djeg e përcëllon. Disa herë, thotë, endem në vendin ku përplasen furishëm emocionet, ku ngjallen amazonat, fluturojnë shqiponja, ngrihen nga varri kryetrima legjendarë, buthtojnë unaza floriri, hahet bukë me uri mbi një magje druri të gdhendur bukur, ikën civil dhe kthehesh ushtar, zemërohesh kot më kot, qesh me ngulm duke rrezatuar vetë mirësi, puth me një tërbim prej burri të unshëm... Ç'nuk gjen dhe mbetesh si i rrënuar nga një katastrofë thjesht natyrore. Princeshën e një bukurie përrallore e kërkon kot aq larg, kur e ke kaq pranë, nëpër këto faqe që kanë filluar të zbehen dhe marrin kësisoj një pamje të gjallë e të fisnikëruar nga motet. Kuptohet vetiu se je mahnitur kur sapo zbulon një rubin tjetër, autentik, ke gjetur proverbin e duhur për ta përmbledhur mendimin. Në Rozafë, në ujëra liqeni e deti, në Dri, Bunë, në fusha e në male, duke rrokullisur fjalë si shkrepa, duke u endur në kopshtet e mrekullueshëm të dashurisë, Zija Çela, pa u ndjerë, pa u kuptuar ku është dhe me ata sytë shpuzë, ku digjet një zjarr i famshëm, vjen në kohë trazirash, merr mbi supe punë unikale krejt të tijat, i ngarkon mbi shpinë dhe ngjitet faqes së thepisur e cila nuk mbaron kurrë, e ndriçuar nga rreze që flakërijnë në mes të ballit dhe në dritë të syrit. Ai qëndron pak, s'lodhet, merr frymë thellë dhe vijon të befasojë e duke parë se pranë ka mijëra e mijëra shqiptarë gjaknxehtë, të etur, të mirë, maskarenj, grabitës, të uritur, punëharruar, gjigantë, të zakonshëm, punëbitisur, pis, të dashuruar, vajtues e vajtojca, krenarë... duke ecur kundër erës së tërbuar. A do ta kenë fatin të kthehen teposhtë? Kurrë! S'ka kthim prapa... Dhe Zija Çela e sheh se s'ka për të gjetur ndonjë gjë përrallore përveçse fatit që po udhëton, në të përpjetën e hidhur bashkë me vendësit e tij, në një kohë kur mund të rrinte më nge dhe të begatonte në hijen e tij...

Zija Çela nuk është shumë larg, ulet diku dhe përkëdhel me sy, gacat e tij të mrekullueshme, si të mbetej rob i përjetshëm i shkrimit të tij, eglendisja më e madhe dhe nëpër udhën e të shkruarit të befason me atë që ndodh në mimikën e tij si të një aktori të madh, brenda lëvizjes së dramës, festës, buzëqeshjes, lotit, drithërimës, ngrysjes së vetullave dhe hapësirës së pamat të ballit të tij të gjerë... Dikush do të pyesë: e ç›lidhje kanë të gjitha këto? Dhe unë mund të them se në këtë mes është misioni ai që ka marrë mbi supe ky romancier e tregimtar që s'di ç'është heshtja. Në një nga kthinat e shtëpisë është tryeza e punës me gjurmët e gishtave të tij përmbi laptop, a thjesht mbi syprinë. Ai shkruan edhe kur fizikisht kjo nuk ndodh. Edhe kur fle, edhe kur rri ulur në kolltuk dhe sheh nga dritarja e veshur me një tis mëngjesi të përjetshëm. Ndryshe nuk shkruhej dot asnjë nga veprat e tij të mëdha që mbushin një bibliotekë të gjerë. Aty keni jetën e tij, keni të birin dhe zgafellën aq të populluar të shpirtit të madh. Ai njeh shumë njerëz, buzëqeshja e tij krejt shpirtërore i ngjitet kujtdo që kalon pranë. Fenomen. Ja tek përkëdhel një statujë, kalon i heshtur me hapin e lehtë nëpër korridore, salla me dhe pa arkada, shtrëngon dorën fort me fshatarët që janë aty rastësisht ose që e duan ta kenë afër. Sepse ky njeri bën *bukën e grunjtë të letërsisë* dhe fshatarit kjo i shkon shumë. Mendo tani që këtë brumë e zë dhe e gatuan, duke përhapur një aromë joshëse dhe tejet ngacmuese për një burrë nga qyteti, buzëhollë, nazeli, i këndshëm, i qeshur, i sertë sipas rastit, krenar me veten dhe jetën që ka bërë, i yshtur tek rri me orë të tëra para një fytyre engjëllore, të bryllët dhe të fshehur nën një magji të mugëtuar. Ky sikur e ka lënë qytetin bosh, madje fshehtas e ka populluar me statuja, luan në amfiteatër, ëndërron kolonada madhështore, ngre akropolë të rinj, falet në kisha e në xhami, përtyp çamçakizë si të jenë thesare të pafundmë, kujton me nderim mitik detin e Velipojës dhe Alpet që ngrihen një hap nga Shkodra e tij!... Ia keni lexuar romanet? Po? Jo? Edhe tregimet? Po mirë. Ah edhe e keni dëgjuar, madje e keni mik. E pra, librat e tij janë shumë të dashur, hyjnë dhe dalin në shtëpitë tona pa teklif, madje edhe na shënojnë ca fjalë që aman o Zot ku i ka gjetur, jo vetëm fjalë dashurie po edhe nga ato që kanë shumë duk, që peshojnë rëndë... Ç'nuk gjen, more vëlla: tuhafë, humbameno, budallenj nga ata që janë me okë rrugëve të shumta të qytetit, nga ata që i zënë edhe me gurë. Ha si ne, ky zevzek, pi si ne, por ndryshon shumë menjëherë sa ulet në tryezë: as ha, as *kundon*, as bën zë por seç lodrojnë ca dritëhije mbi fytyrën e tij me tipare të theksuara dhe aq përfillëse. I dashur tek Zoti, më shumë se kushdo. E gdhin, e ngrys, java shtatë dhe ai tetë aty, mbi letra të printuara dhe mbi laptop. Dhe thotë burri i botës, ja tek jam te kjo hije plot madhështi, edhe vetëm, edhe fillikat, edhe me shokë shumë, me dritë (ah, sa më pëlqen drita!) po edhe pa dritë – sidomos të jetë muzg e mugëtirë, më ngacmon gjithnjë një zë i brendshëm e të eci natën, pale të shkruaj i kredhur thellë në qytetin tim të shkretë dhe qëndisur me një frymë të shenjtë njeriu. Po, unë ëndërroj të fle në jatakët e një miku, të ha nga duart e një nëne mali apo fushe, të pi një gotë me të zotin e shtëpisë ulur pranë buxhakut dhe të xixëlloj dhe unë me kaci prushin nga trungu i lisit në oxhak, të qesh sa të ngopem, të përqafoj sa të mbytem njerëz, pse jo të them vetëm fjalën e ëmbël që vjen vetvetiu, aman një shpirt ma di, të marr më qafë veten time për një fjalë goje, të tregoj shpejt e shpejt diçka për të qeshur, pastaj le të vdes teksa përballë meje lodrojnë sy blu e të shkruar, të them vargje përmendësh, të ngjall histori të vjetra, të humbas rrugëve dhe të gdhihem duke ecur në një pyll të panjohur. Nuk kam të ngopur kur jam në këmbë të malit, aty ia njeh vetes përmasat reale që ke, fuqinë dhe peshën e llahtarshme që hijerëndon para teje...

Tiranë, 28.08.2016

VEXHI BUHARAJA, PA MITE E MJEGULL

nga Yzedin Hima

Figura e Vexhi Buharasë për vite të tëra ka qënë e mbështjellë nga një tis mjegulle, gati mitike. Poezitë e Saadiut, të përkthyera prej tij, në qytetin e Beratit dhe më gjerë qenë mësuar përmendësh edhe nga njerëz të thjeshtë. Buharaja nga lexuesit shihej me adhurim, sikur të ishte autori i atyre poezive dhe sentencave të famshme. Më pas ai nisi të përkthente poetë të tjerë nga persishtja me synimin e hartimit të një antologjie, nisi të lexonte e shqipëronte në portikë, në rrasa mermeri, në vende të shenjta dhe në pllaka varresh, vargje që qenë shkruar në gjuhët orientale. Nisi të përkthente defterët osmanë me zellin e një të pashpresi. Nisi të përkthente "Shahnamenë", por Firdeusi dhe "Shahnameja" e tij nuk njihej nga lexuesit shqiptarë, sepse nuk u botua sa qe gjallë Buharaja. Ai qendronte në shtëpinë e tij modeste për orë të tëra mbi libra me një alfabet ekzotik, lexonte e shkruante deri në mbrëmje vonë. Qytetarët e Beratit e respektonin, e shoqëronin, disa sosh me siguri që edhe e spiunonin, ndonëse ai qe mjaft i përkorë dhe i kujdesshëm në ato që bënte dhe fliste. Flitej se punonte në Akademinë e Shkencave. Banorët e rrugicës së tij çuditeshin me punonjësin e Akademisë që punonte gjithë ditën dhe gjysmën e natës në dhomën e vogël të shtëpisë, që s'kishte asgjë nga hija e rëndë e Akademisë.

Të vjetrit thoshin se V. Buharaja dikur kishte shkruar edhe vetë poezi të ndjera. Askush nuk dinte të thoshte ndonjë varg nga poezia e tij. Në bibliotekën e qytetit gazetat dhe revistat e viteve '40, ku kishte botuar poezitë Buharaja, qenë të rezervuara, që do të thoshte se lexuesit e thjeshtë nuk mund t'i shfletonin. Poezitë e Buharasë qenë strukur në atë kohë brenda burgut të fondit të rezervuar.

Për ta njohur mirë Vexhi Buharanë, së pari duhen lexuar me vëmëndje të gjitha veprat, ato të botuara dhe ato që ai ka lënë në dorëshkrim. Dhe nuk janë pak dorëshkrimet që ai la pas. Për ta njohur Buharanë duhen lexuar edhe pak shkrime e studime për veprën e tij, shkruar e botuar nga njerëz të artit dhe kulturës, para dhe pas viteve'90. Lexuesi i veprës së Buharasë ndjen admirim për përkthimet e tij nga letërsia e madhe persiane, ndjen respekt për përkthimet e monumenteve të historisë sonë kombëtare, dokumente në gjuhët osmanisht, turqisht dhe arabisht, ndjen mirënjohje për përkthimin dhe interpretimin e mbishkrimeve orientale në objektet e kultit dhe në objekte të tjera, ndjen kënaqësi intelektuale kur lexon studimet e tij nga disa fusha të dijes, ndjen kënaqësi të thellë estetike kur lexon ato pak poezi që ai la pas, ndjen keqardhje, kur mëson se ai nuk shkroi poezi pas vitit 1944. Një njeri me dije të thella për kulturën dhe artin kombëtar dhe atë botëror, një njeri që lexonte në origjinal gjenitë e Lindjes dhe gjenitë e Perëndimit, një krijues që shkroi në një moshë fare të re poezi antologjike si "Poeti"dhe "Përpara Tomorrit", e varrosi te vetja poezinë. Vexhi Buharaja ndjeu kënaqësinë e krijuesit në pak botime, krahasuar me dorëshkrimet e tij. Fillimisht ai botoi në revistat dhe gazetat e kohës poezitë e tij të para. Të botuar në libra të veçantë preku poezite e Saadiut dhe "Endërrimet" e Naim Frashërit, përkthime mjeshtërore që nderojnë atë, letërsinë perse nga vjen përkthimi, dhe letërsinë shqipe si letërsi mikëpritëse.

Po cilat janë përmasat e poetit, shqipëruesit dhe dijetarit Vexhi Buharaja? A është ai një krijues periferik në letrat shqipe, një krijues minor që vendoset ose harrohet të vendoset edhe në faqen e fundit të shkrimtarëve krahinorë, apo të një qarku kulturor në historinë e letërsisë shqipe? Cili është vendi i tij në në përkthimin e letërsisë nga gjuhët e tjera në gjuhën shqipe, në përkthimin e dokumenteve monumentalë të historisë sonë kombëtare, në përkthimin e interpretimin e veprave shkencore, mbishkrimeve? A është një përkthyes-rrogëtar që thjesht nxirrte bukën e gojës, apo është një mjeshtër i fjalës? A është thjesht një përkthyes e aq, apo një njohës i thellë i kulturës dhe qytetërimit nga përkthen dhe, gjithashtu, një ekspert i kulturës, i gjuhës, letërsisë dhe historisë kombëtare? Vexhi Buharaja i harruar, i mënjanuar për shkaqe jo letrare e artistike, pas viteve '90, a e ka zënë vendin e refuzuar padrejtësisht? Le të përpiqemi t'u japim një përgjigje modeste këtyre pyetjeve që shtrohen jo thjesht për veprën e V. Buharasë, por edhe për letrat shqipe në përgjithësi. Buharaja shkroi poezi dhe proza poetike nga viti 1939 deri në vitin 1943. Ai botoi në shtypin e kohës nga viti 1940 deri në vitin 1945, kur u botua poezia e tij e fundit.

Poezia e tij i ka të gjithë elementët ligjërimorë dhe përmasat cilësore të poezisë më të mirë në gjuhën shqipe. Ajo thjesht ka qënë fatkeqe si autori i saj. Si rrallë herë, fati i autorit bëhet edhe fati i poezisë së tij. E themi këtë sepse shkëlqimi i djaloshit Buharaja me botime poetike, botime të përkthimeve nga poetë të mëdhenj, puna e tij krijuese në Tiranë, ndërpritet kur ai burgoset dhe detyrohet të bëjë punë të cilat mund t'i bënte një individ që mund të kishte 3-4 klasë shkollë ose të ishte gjysmëanalfabet . Ndërsa Buharaja që kishte mësuar gjuhët e Lindjes dhe të Perëndimit, njihte kulturën, qytetërimin dhe letërsinë e këtyre vendeve, detyrohet të dorëzojë bibliotekën e trashëguar nga të parët dhe të pasuruar nga ai vetë dhe nis të jetojë nën presionin e kontrollit të befasishëm për literaturë borgjeze. Po çfarë ndodhi pas vitit 1944? Buharaja bie në një gjendje absurde pas Luftës. Ai nuk mund të kuptonte deri në fund atë që po ndodhte, atë që do të ndodhte. Duke qëndruar larg luftës, larg urrejtjes klasore, larg etjes për pushtet, por pranë librit, mësimeve të Zotit, letërsisë së madhe dhe punës krijuese, ai binte në një kontrast të thellë me mjedisin revolucionar të viteve të pasluftës. Tani ai nuk ishte i lirë as të krijonte atdheun e vet poetik, ku mund të strehohej pas largimit nga atdheu real me elegancën që e karakterizonte. Poezia ishte shpallur shërbetore e partisë. Nëse nuk shkruhej si e tillë, atëherë dënohej ajo dhe autori i saj. Buharaja tani veç atdheut të lirë që dëshironte humbi edhe atdheun poetik. Ky atdhe i krijuar në vitet e pushtimit fashist u burgos në fondin e rezervuar të regjimit komunist. Absurdi i madh për Buharanë tani qendron në faktin se atdheu nuk mund të krijohej dhe nga atdheu nuk mund të largohej. Ai ishte i dënuar të jetonte në "atdheun e çmendur", sikurse shkruan në një poezi Visar Zhiti. Po për njerëzit me mëndje të ndriçuar gjendet gjithëmonë një zgjidhje. Buharaja nuk ishte nga ata që zotohej të përsoste atdheun real. Ai nuk kishte asgjë prej revolucionari. Pasi ia mohuan edhe krijimin e atdheut virtual poetik, ai gjeti ndoshta të vetmen rrugë, të vetmin shteg, letërsinë e madhe perse, aty "ku syri i lakmisë edhe pas vdekjes kërkon të shohë, ndonëse trupi është zbërthyer e bërë pluhur"*. Me energjinë e një krijuesi të vërtetë, por që e ka të ndaluar të krijojë atë që di dhe dëshiron, ai e derdhi tërë këtë energji në

përkthimet e tij, të cilat janë, në fakt, rikrijime të tij. Ky njeri u ndje i lirë dhe i magjepsur në vetminë e tij, teksa gërmonte në gjuhë dhe gjente smeraldë të tillë:

U drodh nga llahtari Dahhak pamjeferri
*Për pak mushkëritë i shkuli nga tmerri.**

BUHARAJA SHQIPËRUES

Po cili është vendi i Buharasë si shqipërues në letrat shqipe? Të gjithë studjuesit, njohësit e letërsisë së orientit dhe gjuhëve orientale vijnë në një mendje ku flasin dhe shkruajnë për shqipërimet e V. Buharasë. Ata pohojnë se V.Buharaja është një mjeshtër i madh i përkthimit të letërsisë orientale në gjuhën shqipe. Ai qendron me dinjitet në krah të Nolit të madh. Botimi kohët e fundit i "Shanamesë" së Firdeusit është një tjetër dëshmi monumentale për shqipëruesin Buharaja. Edhe botimi i përkthimeve të Buharasë nga gazeta e Sami Frashërit "Terxhuman-i Shark" (në shqip, "Lajmëtari i Lindjes") është pritur me interes nga studjues të ndryshëm Midis tyre spikat botimi i veprës së dijetarit Hasan Tahsini dhe komentet mbi këtë vepër, shqipërimi i vëllimit poetik të Naim Frashërit shkruar në persisht "Endërrimet", përshtatjen "Katër stinët" etj.

SAADIU DHE BUHARAJA

"Vargu jeton jetën e brendshme të autorit të tij" - shkruan Vexhi Buharaja në parathënien e Gjylistani dhe Bostani të Saadi Shirazit, i quajtur edhe Shekspiri i Lindjes. Është një thënie që të trondit, vetëm me një fjali, gjithësej gjashtë fjalë.

Poezia që shpirtëzon sende : deti qesh, lumenjtë vrapojnë, mali hesht, në këtë rast shpirtëzohet vetë: Vargu jeton! Brenda një fjalie Buharaja na jep një përcaktim për poezinë e Saadiut, që të tjerët do të shpenzonin fraza të tëra për të shpjeguar se poezia e tij ka një ndjeshmëri të lartë, se ajo përcjell botën e trazuar shpirtërore të autorit, se te vargu autori derdh shpirtin e tij, etj. etj. Ndonëse janë shpenzuar fjali të tëra nuk janë thënë pikërisht atë që Buharaja nënvizon në një fjali të vetme: "Vargu jeton jetën e brendshme të autorit të tij!"

Brenda thënies së Buharasë kemi përdorim të kohës së tashme të foljes jeton. Ai nuk përdor kohën e kryer e thjeshtë: Vargu jetoi jetën e brendshme të autorit të tij, por kohën e tashme që do të thotë se edhe pse kanë kaluar shtatë shekuj nga vdekja e Saadiut (1203 ose 1210- 1290), vargu jeton, në mënyrë të pavarur nga autori i tij. E vetmja varësi është se vargu jeton pikërisht jetën e brendshme të autorit. Pra jeton jetën e brendshme të Saadiut. Buharaja i ka kursyer gjuhës fjalë e fjali të tëra etj. etj. Buharaja në një fjali me gjashtë fjalë ndëkohë ka kryer punë duke kumtuar gjithçka ka të bëjë me gjeninë e poetit, pavdekësinë, jetën në shumë trajta dhe vende të të njëjtit shpirt (shpirtit të Saadiut) etj. Ky fakt tregon se Buharaja kishte të gjithë instrumentat intelektualë dhe shpirtëror për të depërtuar në artin e madh të klasikëve persë dhe artit në përgjithësi.

Një zjarr që të ndezë e veja në zi
Shum' herë qytetin e djeg e bën hi,

shkruan Saadiu te "Bostani". Vargjet jetojnë jetën e brendshme të autorit, siç tha

Buharaja më lart, por padyshim këto vargje të bukur në shqip jetojnë edhe jetën e brendshme të përkthyesit të shquar.

FIRDEUSI DHE MEDIUMI BUHARAJA

Firdeusi jetoi në shekullin X- XI. Buharaja, në parathënien e përkthimit të "Gjylistani dhe Bostani" shkruan: " Veprën e Dakikiut e vazhdoi dhe e përsosi gjeniu botëror i Iranit, Firdeusi (934 -1020 ose 1027) me "Shahnamenë" e tij të pavdekshme, vepër monumentale e gjuhës dhe e poezisë persiane."

Pas nëntë shekujsh e gjysëm "Shahnameja" erdhi në gjuhën shqipe, fatkeqësisht jo në përmasat e saj. Nëntë mijë vargje që "jetojnë me botën e brendshme të autorit" erdhën të jetojnë në një tjetër gjuhë, në gjuhën shqipe. Po si erdhi shpirti i derdhur në fjalë i Firdeusit në vargjet shqip? Nëpërmjet shpirtit të Buharasë. Mediumi qe Vexhi Buharaja. Shpirti i tij u vu në kërkim të shpirtit të Firdeusit dhe e gjeti në thellësi të kohrave. Nëse trupi i Buharasë kishte rreth 40 vite që sillej në këtë botë, shpirti përshkoi nëntëqind vjet, deri sa takoi sivëllain e tij, shpirtin e Firdeusit. Mediumi Buharaja me shpirtin e poetit të madh të gjuhës perse brenda enës së tij, përcolli mesazhet e kryeveprës në gjuhën shqipe. Janë nëntë mijë vargje që jetojnë jetën e brendshme të autorit, Firdeusit dhe jetën e brendshme të shqipëruesit, Buharasë.

Vëreni vargjet e magjishëm të Firdeusit nga "Shahnameja", sjellë në shqip nga Buharaja. Është fat për gjuhën, për letërsinë, për kulturën tonë që kjo pasuri është në fondin e tyre. Rrëfenja "Feriduni i hedh prangat Dahhakut":



"Mos bëj gjë të ligë në botë sa mund!
Së mirës mbështetje t'i bëhesh gjithkund.

Kur s'rrojtkan përjetë e ligë dhe e mirë,
e mira të mbetet kujtim i pavdirë.

Thesarët e fryrë dhe i larti pallat
aspak nuk të sjellin gaz, jetë dhe fat."

Dhe nga rrëfenja "Zali njihet me Mihrabin":

"Një çupë të fshehur ky mban në saraj,
që dritës së diellit ia shkon drit' e saj.

Nga koka te këmbët - fildish që rrëmben.
Nga shtati si plepi, fytyra - Eden.

Dy laqe prej myshku mbi supet si borë,
si hallkat e prangës mbështjellë kurorë.

Si lulja e shegës e kuqe fytyra,
si kokërrza shege dy buzët nga ngjyra.

Dy sytë e vashës si bathra në maj,
si krahët e korbit qerpikët e saj."

Cila ka qënë magjia që i ka bërë gjuhës Vexhi Buharaja për të arritur deri në këtë lartësi ligjërimi, nga ku vërtetë të merren mendtë? Cili ka qënë çelësi i depërtimit deri në këta kufij maksimalë të aftësisë shprehëse të fjalës? Mendoj se së pari ka qënë gjenia prej krijuesi e Firdeusit dhe së dyti gjenia prej shqipëruesi e Vexhiut.

Distiku : Dy sytë e vashës si bathra në maj / si krahët e korbit qerpikët e saj / është një rubin në gjerdanin e artë të poezisë që lexohet në gjuhën shqipe.

Shqipërimet Vexhiu, në shumë raste, i ka shoqëruar me shënime të natyrave të ndryshme. Në këto shënime ne zbulojmë tek ai gjuhëtarin, kritikun, historianin, filozofin, polemistin. Dhe këto shënime mbeten një fushë e hapur dhe me shumë interes për çdo studiues. Edhe pse këto shënime të dhëna shkurt, është thënë aq sa është quajtur e mjaftueshme, ashtu siç ka thënë edhe Noli i madh, aq sa ishte e nevojshme, në introduktat që kanë shoqëruar shqipërimet e tij. Është e njëjta traditë, që duhet vlerësuar. Në shënimet që shoqërojnë shqipërimet e Vexhiut, bëjnë vend edhe sqarime për kuptimet e fjalve specifike të përdoruara, për sinonimet që ndjekin fjalët e rralla, shprehjet frazeologjike, barbarizmat të përdorura për të dhënë atmosferën e kohës dhe të vendeve të Lindjes nga vjen kjo poezi, si dhe vërejtje dhe sqarime të ndryshme për kuptimet e vargjeve që mbartin ngarkesë filozofike ose mitologjike

BUHARAJA STUDIUES

Sa për atë pjesë të pyetjes nëse Buharaja është thjesht një njohës i gjuhëve orientale, mjafton të lexosh shënimet në përkthimet e tij, shënime që nuk mungojnë kurrë, dhe do të mësosh se V. Buharaja është një njohës i thellë i kulturës, historisë, i artit dhe letërsisë së vendjeve të Lindjes nga i mori dhe i bëri kryeveprat të flasin shqip, është një njohës kulturës, artit dhe letërsisë së Perëndimit.

Buharaja është një studiues serioz. Kur lexojmë studimet e tij vëmë re qartësinë dhe logjikën e ftohtë të argumentit, thellësinë e trajtimit të çështjes, njohjen e këndvështrimeve të tjera për të njëtën çështje dhe këndvështrimin origjinal të Buharasë.

"Ka qene viti 1971, kur une gjate nje udhetimi ne Berat kerkova te shihja me syte e mi dy simbole: nje skulpture druri, qe perfaqesonte ritin e sakrifices njerezore ne nje nga kamaret e ures mbi lumin Osum, pra, imazhin e gdhendur te nje simotre te Rozafes ne Berat dhe nje njeri te gjalle, te identifikueshem me nje simbol antropomorf gjithashtu te sakrifices, qe quhej Vehxhi Buharaja ," - shkruan Moikom Zeqo.

E sollëm këtë vizatim të goditur të poetit dhe studjuesit Moikom Zeqo pikërisht për të ndërtuar një anë tjetër të portretit të Vexhi Buharasë, atë të vetsakrifikimit të tij të heshtur, ndriçimit latent të mendjes së tij mbi monumente të historisë sonë kombëtare, mbi monumente të artit të madh botëror, duke i sjellë në një shqipe të qashtër. Puna e tij i ngjet atij gdhëndësit të famshëm që duke parë statuetat e gdhendura me mermerin e një gjuhe antike, nga poplat e një tjetër gjuhe, të gjuhës shqipe, i duhej të dallonte mermerin në zemër të tyre dhe të gdhëndte të njëjtat forma.

Sofra e Buharasë është vërtetë e begatë. Ai punoi një jetë të tërë që ta pasuronte atë, por rreth saj u ulën miq e dashamirës, ziliqarë dhe grabitës.

Në veprën e tij futën duart dhe morën atë që kishin nevojë, shuan etjen intelektuale, por edhe përvetësuan punën e Vexhi Buharasë, individë që ia lavdëruan dhe nderuan punën, por edhe që nuk denjuan as t'i përmendin emrin përkthyesit dhe interpretuesit të shquar.

Këta mund të quhen bukëshkalë, sepse e harruan, pas shuarjes së urisë, sofrën ku hëngrën dhe emrin e atij që e shtroi atë sofër. Disa, madje, në mënyrë krejt të paturpshme vendosën emrat e tyre poshtë përkthimeve dhe interpretimeve të Vexhi Buharasë. Këta mund të thirren thjesht vjedhës ordinerë të pasurisë së tjetrit.

"EKLIPS" SI PARATEKST I ROMANIT "OH"

nga Behar Gjoka

Dëshmi e shkrimit me dy zhanre dhe variante gjuhësore, si dhe me dy versione letrare, është rasti i romanit *OH* që, në fakt, është një bartje e situatës estetike me realitetin e prozës *Eklips* [1]. Këto tipare të afrive shkrimore, ndërmjetshëm, dalin në pah nga një përqasje formale e prozës *Eklips*, që me shumë gjasa sendërton tipologjinë e novelës me tekstin e romanit *OH* [2]. Kuptohet se, ndërkaq, romani *OH* është shkruar fillimisht në variantin e gegnishtes, pastaj është kaluar në situatën e konverguar me variantin e njësuar, gjë që të përkujton gegnishten e Camajt, si një refuzim gjuhësor dhe letrar, gjithnjë si një rrugëtim vetjak në shtjellat e letrares. Teksti *Eklips* [3] vetiu krijon premisë diskutimi mbi zhanrin letrar që përfaqëson, sepse është përfshirë te vëllimi me tregime, e cila zbulohet e përshkallëzuar si formësim përmbajtësor dhe shprehësi letrare. Prozat e paraqitura në librin *Glantina*, botuar të bashkëlidhura me pjesët e tjera në vitin 2005 nga shtëpia botuese "Faik Konica", janë paraqitur në këtë formë:

I. *Më tej*, ku gjenden dhjetë proza dhe dy tekste me dy variante gjuhësore dhe versione letrare.
II. *Pakëz më tej*, që përmban gjithsej njëmbëdhjetë tregime, por edhe pjesën më të madhe të varianteve të tregimeve, sepse janë përfshirë pesë tekste në prozë në këtë larmi shkrimi.
III. *Edhe pakëz më tej*, ku përsëri janë venduar njëmbëdhjetë tregime, si dhe katër proza të shkruara në dy variante gjuhësore dhe versione letrare.
IV. *Sall edhe pakëz më tej*, ku janë përfshirë dhjetë proza, një tekst, *Vdekja solemne*, në dy variante, si dhe proza *Eklips*, që përkon me zhanrin e novelës.

Nga ana tjetër, nga njohës të jetës dhe veprës letrare të Anton Pashkut, e sidomos të kësaj proze, ka pohime të ndryshme, që në mënyrë eksplicite shënojnë novelën, pra një zhanër që dukshëm e tejkalon tregimin. Kështu, Shaip Beqiri në përcjelljen që i bën librit *Glantina*, shkruan: *...dy variante të botuara të novelës* Eklipsi *(1968), përkatësisht të romanit* OH *(1971)*[4], duke larguar përfundimisht mëdyshjen se *Eklips*, që është paratekst i romanit *OH*, është një prozë që lëvron novelën si lloj letrar. Teksti i novelës *Eklips* përpunohet dhe rishkruhet si roman, me titullin *OH* (po flasim për variantin e përfunduar), si një ligjërim që tipologjinë e shprehjes së gegnishtes e ka parësore, por, megjithatë, shpesh ka ndërfutur elemente të gjuhës së njësuar, parë si një akt refuzimi dhe pranimi, pra diçka më shumë, si energji fjale dhe jo si një akt jashtëletrar. Megjithatë, në shkrimin e prozës së gjatë, që materializohet me tekstin e romanit *OH*, kemi disa momente që luajnë rol parësor në sendërtimin e letrares:

A. Teksti *Eklips*, pra parateksti i romanit *OH*, që ka pasur një situatë të përveçme gjuhësore dhe letrare, sepse është shkruar në variantin e gegnishtes, e mandej teksti romanor, që shkruhet në një situim konvergues të gegnishtes dhe gjuhës së njësuar, mundëson shansin e përqasjes, brenda së njëjtës situatë, si frymë dhe teknikë shkrimi, por edhe si zhanre të ndryshme. Kjo ndërlidhni e një situate të mirëfilltë paratekstuale të sendërtimit të romanit në formën përfundimtare hetohet në të gjitha elementet formësuese të etosit dhe pathosit të veprës. Prania e paratekstit, me gjasë e një varianti romanor të shkruar në gegnisht, ku në krye të herës shkruhet novela dhe në një moment të dytë rishkruhet si roman (Ky tekst nuk më ka rënë në dorë dhe prandaj do të mjaftohem vetëm me përmendjen e këtij fakti.), mandej shkruhet teksti me dy trajta gjuhësore dhe letrare. Në pamje të parë, ky akt shkrimi i dy llojeve letrare sa të befason, po kaq e ndërlikon vetë procesin e leximit dhe interpretimit të dukurisë që shpaloset në prozëshkrimin e autorit, sidomos në ndërkomunikimin e këtyre dy teksteve, që pasojnë mënyra dhe trajta të ndryshme shkrimi. Kjo rrethanë e aspektit përpunues dhe ndryshues e vendos krijimtarinë e Pashkut në piketat e poetikës moderne të shkrimit letrar si variante dhe versione letrare.

B. Ndërmjet novelës *Eklips* dhe romanit *OH*, dy tekste që pasojnë njëri-tjetrin në marrëdhënie paratekstuale dhe hipertekstuale, gjë që e thellon mundësinë e zbërthimit, të bashkëlidhnisë në rrjedhat subjektore, si dhe në skicimin e personazheve, ndërkaq vihet re edhe ndryshimi në ligjërimin gjuhësor, krahas versionit letrar të rrokshëm, qoftë edhe si prani e dy zhanreve të prozëshkrimit në letrat shqipe. Kjo rrethanë e ndërlikesës së varianteve të ndryshme zhanrore, gjuhësore dhe letrare, si dhe ndërlidhnia paratekstuale, përplotëson përmasën e lëvruesit modern të prozës. Në shkrimin e romanit kemi parë gërshetimin e gegnishtes me shkrimin në gjuhën e njësuar, pra situatën e konvergimit letrar të formave të ligjërimit gjuhësor. Në tekstin e prozës *Eklips* ndryshimi parak është në zhanrin e lëvruar, gjithashtu shkrimi i prozës së gjatë, me anë të gegnishtes, që ruhet në variantin e parë të romanit. Në anën tjetër, romani *OH*, pra teksti përfundimtar, e ka thelluar kahen konverguese me gjuhën e njësuar pa e bjerrë variantin e gegnishtes.

C. Dy tekstet, *Eklips* si novelë dhe romani *OH*, pra dy dëshmitë e lëvrimit të prozës, në dy tipa zhanrorë, njëherit përfaqësojnë dy versione letrare, që tashmë duhet të shqyrtohen edhe në këtë situatë të dhëniemarrjes së ndërsjellë. Ndryshimet në mes tyre janë thelbësore, së pari për zhanrin e lëvruar, të novelës dhe romanit, prej shkrimtarit, së dyti, mbase edhe prej shkrimit në dy variante gjuhësore të shqipes, një risi që nuk është trajtuar nga studimet gjuhësore dhe letrare, sa i përket trashëgimisë së prozës së Pashkut. Së fundi, nga zgjerimi i hapësirës tekstologjike në faqet e romanit *OH*, gjithsesi duke mbetur stilistikisht në vatrën e novelës, që krijon një situatë tjetër të kumtit letrar, tashmë të një romani, të shtrirë në linja dhe përshkrime, realizuar me dy versione letrare dhe gjuhësore, që përbën një veçanësi në letrat shqipe, në harkun e bashkëkohësisë.



Prania e disa çështjeve të ndryshme, sidomos të situatës së përveçme të kapërthimit dhe ndërlidhjes hipertekstuale dhe ndërtekstuale, të sendërtimit të prozës, njëherit në dy zhanre dhe versione letrare, si dhe të dy a më shumë varianteve gjuhësore, përbën një moment më vete të teorisë letrare mbi ngjyresat e secilës formë zhanrore, por edhe të aspekteve të stilistikës gjuhësore dhe letrare. Po kaq, teksti i novelës dhe romanit, pra i dy zhanreve të ndryshme të prozëshkrimit, bartin edhe problematikën e lëvrimit gjuhësor, sepse shqiptohen edhe në dy variante gjuhësore, gegnisht dhe të konvergimit të këtij varianti me gjuhën e njësuar. Prania e rrokshme e dy zhanreve dhe dy versioneve letrare, po ashtu e dy varianteve gjuhësore, megjithatë, kërkojnë përgjigje më të thelluar nga ana e studimeve gjuhësore dhe letrare. Kjo rrethanë shkrimi, e lëvrimit në gegnisht dhe në variantin e konverguar, në përqasjen dhe vijimësinë ligjërimore, në lidhje me lëvrimin e tregimeve fantastike, kryesisht aty ku ndeshet larmia e shkrimit me variante gjuhësore dhe versione letrare, tashmë duhet verifikuar dhe zbërthyer si cilësi e shkrimit letrar të autorit. Në radhë të parë, vështrimi dhe sqarimi në rrafshet gjuhësore të sistemit të shqipes merr një peshë specifike, sepse proza e Pashkut shënon kapërcyellin e momentit kur diskutohet për ta ndaluar variantin e gegnishtes si ligjërimi letrar. Megjithëse ky variant me veprën e Buzukut, Budit, Bardhit, Bogdanit etj. pati hedhur themelet e shkruara të gjuhës shqipe, në kohët moderne po binin për të kambana alarmi. Prozën e shkruar prej autorit në variantin e gegnishtes, që përfaqëson kulmim letrar të njëmendtë, autori e pati përmbushur në tregimet për fëmijë dhe të rritur, duke e dëshmuar kështu vijimësinë e lëvrimit të këtij varianti. Pra, për të mos dalë nga sistemi i gjuhës shqipe, autori shkruan edhe në gjuhën e njësuar, madje duke konverguar gegnishten me këtë formë shkrimi, prirje që e ndeshim edhe në shkrimin e poezisë dhe të prozës nga ana e Martin Camajt, ku ndeshim një identifikim më të plotë të gegnishtes, madje edhe të shenjave të arbërishtes.

Momenti i kapërcimit të pragut i cili, sipas studimeve gjuhësore dhe letrare, hap një kapitull tjetër të shkrimit të letërsisë së njësuar, detyrim që sërish Pashku e përmbushi me sukses, përbën një situatë që kërkon hulumtime të thelluara mbi variantet gjuhësore, tashmë duke rishkruar në variantin e njësuar disa tregime fantastike të prozës për të rritur, por edhe të prozës për fëmijë. Shkrimi i prozës në dy variante gjuhësore, gegnisht dhe e njësuar, përmbush tiparet gjuhësore dhe letrare për të përfaqësuar versionet letrare, gjë që përqaset në dy tekste, novelën dhe romanin, të realizuara në kohë të ndryshme. Tipologjia e versionit letrar, përgjithësisht e painterpretuar nga studimet letrare dhe gjuhësore, del në disa proza të autorit, mjaft e qartë në rastin e novelës *Eklips* që është një paratekst i romanit *OH*, ku madje spikatet prania e variantit gjuhësor dhe letrar. Duke bartur shenjën e dyfishtë, novela *Eklips*, si variant gjuhësor dhe version letrar, si dhe paratekst i romanit *OH*, ka rëndësi interpretimi i këtij fakti, për tiparet që përçon vepra letrare e Pashkut. Pavarësisht vështirësisë së shkrimit, ligjërimi në dy variante



gjuhësore dhe versione letrare do të duhet kthjelluar për tregimet e Pashkut. Këto tregime, plasuar me dy variante dhe versione, gjuhësore dhe letrare, në dymbëdhjetë tregime fantastike, përbëjnë një fakt unik të shkrimit letrar bashkëkohor. Teksti *Eklips*, si lëvrim i novelës, si rast i shkrimit në gegnisht, ka vlera në përqasje me romanin *OH*, i cili e ka si paratekst novelën dhe romani sendërgjohet me dy variante gjuhësore, në gegnisht dhe në një përpunim të shkrimit të konverguar të këtij varianti me gjuhën e njësuar. Në qendër të novelës janë dy personazhe, një femër dhe një mashkull, ashtu si në romanin *OH*, që mendohet se janë bashkëshortë që, megjithatë, kanë mbërritur në zgripin e marrëdhënies së tyre, mbase në përfundimin e plotë të saj. Në rrethanat absurde, ku asnjëri prej tyre nuk ka emër, janë Ajo dhe Ai, gjë që e bën situatën e realitetit letrar edhe më enigmatik. Të dy jetojnë në botën e mbyllur dhe të mistershme, sepse pothuajse kanë ikur nga komunikimi. Prandaj, le t'i besojmë Bartit se:

Të lexosh, do të thotë ta dëshirosh veprën, do të thotë të duash të jesh vepra, do të thotë ta refuzosh ta dyfishosh veprën jashtë çdo të foluri tjetër pos të folurit të vetë veprës (...) Të kalosh nga leximi në kritikë, do të thotë ta ndryshosh dëshirën, do të thotë ta dëshirosh jo më veprën, por ligjërimin e vet (...) [5]

Në ato raste, ndonëse tepër të rralla krahasuar me kohën e qëndrimit bashkë, kur e shkëmbejnë ndonjë fjalë, më shumë e gërgasin dhe e shpotijnë sho-shojnë. Nga njëra anë, del e plotë qenia njerëzore, paraqitur me të dyja anët e medaljes, femra dhe mashkulli, që në morinë e tipareve të përbashkëta dhe dalluese janë afër, njëherit janë po kaq larg, të ngujuar në këtë afrim paradoksal, kur janë tepër larg, prej kohësh. Kur kemi mbërritur në hapësirën e tekstit, në çastin kur mashkulli dhe femra largohen nga njëri-tjetri, madje deri në moskthim, ikja prej lidhjes dhe komunikimit të një situate përfundimtare. Megjithatë, shpeshherë femra dhe mashkulli kanë nisur të kërkojnë brenda vetes, diku në thellësi të nënvetëdijes, ka gjasa si një mënyrë e mjegullt për ta zbehur disi ikjen prej njëri-tjetrit. Prandaj, mund të thuhet se në këtë rebus të beftë të novelës, në femrën dhe mashkullin, të dy protagonistët sërish janë dy anë dhe nivele, ku njëra është e dukshme, ndonëse sipërfaqësore, tjetra ka mbetur më në hije. Ana tjetër gjendet e fshehur në padukshmëri, që nxjerr krye në formën e siluetës apo hijeve të kohërave të ndryshme. Dyzimi, ku secili prej protagonistëve, pra mashkulli dhe femra, të cilët janë kredhur në pezulli dhe ekstazë, ku qenia është dhe nuk është aty, përbën bazën e kumtit të kësaj proze të përveçme të autorit. Shumëfishimi i ekzistencës së qenies, në skalitjen e botës përqark, në figurimin e mashkullit dhe femrës, shënon thelbin e poetikës së rrëfimit të novelës *Eklips*, që më vonë do të bartet në hapësirat e romanit *OH*, një tekst me natyrë moderne dhe fantastike. Prania e shkrimit të prozës, në dy tipologji zhanrore, pra novela *Eklips*, dhe teksti romanor, duke ardhur që të dy tipat në nivel të ngritur estetik, është një tregues i shkrimit të prozës prej Pashkut, pra e të tria zhanreve të saj, por edhe dëshmi e vlertë e lëvrimit të versionit letrar.

---

[1] Botohet për herë të parë si novelë dhe shkruhet në variantin e gegnishtes.

[2] Romani që botohet me titullin *OH*, që shkruhet në gegnisht fillimisht, dhe rishkruhet duke ndërthurur gegnishten me gjuhën e njësuar.

[3] *Eklips* është paratekst i romanit *OH*, duke sjellë një përvojë dhe një model artistik të realizimit të versionit letrar.

[4] Beqiri, Shuaip: *Glantina*, "Faik Konica", Prishtinë, 2005, faqe 414.

[5] Barthes, Roland: *Aventura Semiologjike*, "Dukagjini", Pejë, 2008, f. 208.

BESO

tregim nga Bajram Sefaj

...e u bëfsh qyqe mali atje në maje
ku zemra s'prek e syrin e ndjell lakmia
Y. Shkreli

Nis e sos!

Gjersa po shtypja rreshtat e kallëzimit katil, mbi pulën me këmbë të verdha, apo të ndonjë tjetri para tij, ama-na! (për shembull), mendje s'më shqitej dot, oborri i shkollës fillore të katundit tim Anës Drinit.

*

Atë ditë, pranverore qe, më së paku i ngjasonte kësaj stine, oborri i shkollës nxinte, nxinte nga frika dhe tmerri i vogëlushëve shkollarë, kur, si thnegla, ishin dyndur gjithkund dhe kishin pushtuar çdo skutë e birucë.

Në vend se të pushtohej nga ngarendja, nga valët e buzëqeshjeve mëngjesore të kalamajve, veç sa po nisnin të shijonin jetën, oborrin e shkollës, e pllakoste një heshtje e trashë, e frikshme, si e kobshme!

Ishte ditë vaksinimi.

Vaksinimi, duhej të ishte digë e pritë, kundër ndonjë epidemie të ligë e shfarosëse, të rrezikshme, që u kanosej fëmijëve, filizave të rinj në pranverë, sidomos...

*

Të gjithë, si trumcakët në shi, ishin strukur pas njëri-tjetrit. Tkurrur si sardele të imëta, në konservë!

Unë, ndërkaq, nxjerr kraharorin (gjoks pule!) dhe, me mëngë të këmishës arna-arna përvjelë, i prija kolonës, triumfalisht. Isha në krye kolone!

Si një Skënderbe, miniatural.

Bash si një prijës i paepur. Sypatrembur!

Në daç beso, në daç mos beso!

*

Mantelet e bardha, infermierë e infermiere, ndanin diçka. Jepnin diçka atje. Rreth një tavoline të madhe. Qoftë edhe majë gjilpëre. E kjo ishte boll. E imët sa përbirohet përmes veshëve të gjilpërës, si përmes thimthit të gjarprit anakondë, apo të ndonjë tjetri gjarpër akoma, ende, hala..., më helmues se ai.

E pabesueshme fare!

E pabesueshme, por e vërtetë, e vërtetë përvëluese e lakmisë së madhe, mospërfillëse saqë i prish, i shkatërron e i drobit krejt kodet e logjikës, të mundësisë së mundshme!

*

Ec e kuptoje, në kohë të sotme, një absurditet të tillë mahnitës. Vetëflijues!

E lakmoja, e lakmoja atë helm, majë gjilpëre. Jashtëqitja, vjellja e saj, më jepej falas!

A ka fare limit kjo bimë e keqe që, keq kishte zënë rrejë në zemrën (shpirtin) e një qenieje të brishtë njerëzore, kur me ngulm lypte hise në jetë!

*

Me zë lartë i bërtas vetes, në vetminë shurdhmemece. Deshi këmishë trishtimi, i qullur në djersë vdekjeje, tash një natë frik, gjersa kujtoja këtë skenë fëmijërie, që luhej aty, në oborrin e shkollës sime fillore në fshatin Anës Drinit...

E pi një gotë ujë të ftohtë.

Veten e marr më të mirë...

*

N'daç beso, n'daç mos beso!

(Shkëputur nga vëllimi me tregime Prozë urbane, ShB "Faik Konica", Prishtinë 2019, faqe 155-158. Ripranverohet në stinën pa lule, Corona virus).

NUK IA KEMI QITUR PIKËN

Ese nga Rexhep Ferri



1.

Po vjen dikush.
Me mashtrime e me gabime.
Jam vetëm. Krejt vetëm...
Të gjitha këto katrahura kush mund t'i mbajë mend?
Ma prishin mendjen.
Ma prishin gjakun.
Sa për pse, s'dua të mendoj shumë.
Për vetëgabime, vetëmohime, s'ka nevojë për shpjegime.
Nuk dua të jap përgjigje të gabuar.
Është e vërtetë.
Të gjithë kemi frikë.
Për thellësinë e vet, deti kthehet.
Në lëkurën time edhe unë po kthehem.
Nuk dua të jem dikush tjetër.
Koha e keqkuptimeve qenka dritare e vdekur.
Naivitet i pastër.
Deri te pasqyra, analizë e dyshimtë.
Edhe kur e humbim, edhe kur e kërkojmë.
Jeta i ka ligjet e veta.
Bisedat e veta.
Bindjet e veta.
Për të gjitha ndryshimet, kur jemi mendjelehtë.
S'po mund të besoj.
S'po mund të ndalem.
Dy mijë vjet janë pak për t'i harruar.
Qytetarëve u kujtohet *Darka e fundit* e Leonardo da Vinçit kur Jezu Krishti tha:
"Njëri nga ju do më tradhton!"
Kjo tradhti vjen deri te personazhet e ditëve tona.
Në kasaphanën e hajdutëve, ku harami i katundit tonë e preu bardhoken e Anton Pashkut.

2.

Për kohën që nuk e kishim, kot kemi besuar se ëndrrat janë kujtime të gjalla.
Kush humb, humb.
Ne menduam se fituam.
Ende nuk po besoj.
Mashtrimi shkoi më larg se ëndrra e vonuar.
Me kohën e kohërave të shpejta ende nuk po mund ta kuptoj se kush jam.
Vetes i thashë: gjeje fillimin, mesin, fundin.
Për kohën e ardhshme ra një heshtje.
Dreqi ta hajë!
Kishim qenë shumë të etur e të uritur.
Natyrshmëria ku shkoi?
Buzëqeshja e fytyrës si na humbi?
Idealistët, pas idealit, kaluan përtej ardhmërisë.
Të pyesësh çfarë po ndodh me ne është pak e besueshme.
Kot presim farë përgjigjeje nga të vdekurit.
Jo fashizmi, fashizmi.
Jo komunizmi, komunizmi.
Jo bizantizmi, bizantizmi.
Jo anadollizmi, anadollizmi.
E jo atdhetarizëm, pa atdhetarizëm e pa atdhe.
Kur e ëndërrojmë të panjohurën.
Kur e harrojmë kuptimin e fluturimit nga Maja e Lekës.
Faleminderit pasqyra ime.
Hënën e mesnatës e pyeta: ku ishe?
Sa di unë, me ju kisha lënë një takim, më tha.
Kur asgjë nuk ndodh, portreti i njeriut vjen si pyetje, si pikëpyetje, i thashë.
Ajo qeshi.
Aty ku peizazhi largohet, çka pret, dhe tha:
Mos harro, deri këtu unë.
Më vonë ta shohim ku ia kemi qitur pikën.

3.

Për aq sa jemi, me hyrje e dalje në jetën e Prometeut, në këtë shekull
të pakuptueshëm, sa për ta kaluar radhën njeriu e kërkon kohën e vet.
Nëse historia e çel gojën, prisni sa të shkoj në Shkodër, te Kel Marubi,
të marr një fotografi dokumentare.
Ideja e fundit nuk është fundi.
Diçka kam thënë.
Diçka kam harruar.
Lufta në të cilën kemi qenë le të na kujtohet.
Me profilin tonë të papërfunduar e me lirinë që e fituam
dhe që e humbëm pa e parë e pa e përjetuar.
Për shijen aristokrate të sojlive tanë nuk do të vonohem.
Nuk do të ngutem.
Rebeli i mutit, ku po shkon, vetes i thashë.
Për mendjen tënde në Pazar ka më shumë pyetje se përgjigje.
Në këto orë të liga, mes nesh dhe lirisë ndoshta na ka lënë dëshira që të kuptojmë se kush po shet e kush po blen pa paguar asnjë grosh.
Kjo histori, çfarë historie.
Kur jeta nuk ta kthen përgjigjen, kush e ka menduar se jemi kaq mendjelehtë?
Unë ende s'e kam parë veten.
Kush dreqin duhet të jetë ai tjetri?
I provova të gjitha besimet.
Me rrezikun e çmendurisë e shtrëngova grushtin.
Para pasqyrës e theva hundën.
Nga inati e mbylla gojën.
Për botën e botës së vogël, çdo lumë derdhet në det.
Deti në oqean.
Oqeani, nga temperatura mbi njëqind, avullohet.
Ngrihet lart, deri te retë e bardha.
Deri te retë me diell e shi.
Nga retë e ngjeshura bie në tokën e bekuar si shi, shi, shi...
Në tokën e vet.
Për njerëzit e uritur e të etur.

4.

Për fatin tonë të keq, nga lufta e më shumë nga paslufta,
s'kemi çka të presim e as çka të themi.
Sa për kohën, gjithmonë e kemi humbur kohën.
Ndoshta na ka harruar Zoti apo ne e kemi harruar Zotin.
Historikisht, për ta kuptuar njëri-tjetrin kurrë nuk do të takohemi.
Mes nesh, çfarë besimi, keqkuptimi...
Për asgjë më pak, për asgjë më shumë na ka humbur besimi.
Ishte ëndërr.
Ishte maskë.
Ndonjëherë nuk shoh asgjë.
Njeriu, edhe pse ka zemër, ende nuk e ka të qartë çka kërkon.
S'ka rëndësi kush fiton.
Kush humb.
E kotë, të besosh.
Njeriu nuk duhet të bëjë krejt çka mund të bëjë.
Atëherë, kush e zotëron.
Luftërat janë fat i të çmendurve...
Si do ta kalojmë këtë shekull me të gjitha këto çmenduri e rrugaçëri
të qytetarllëkut të rrejshëm?
Të heronjve të vetëshpallur heronj.
I kanë zënë të gjitha pozitat.
S'ka zot që i ndal.
Dikush humb.
Dikush fiton.
Dikush grabit.
Koha është për të festuar.
Largohuni nga rruga, dikush më tha.
Djalli po lufton krimin.
Njeriu s'ka se çka të kërkojë më shumë.
Ju kam shqetësuar duke ju thënë se një ditë do të bëhet mirë.
Harroni premtimet.
Në kohë të liga, jeta nuk ka përgjigje.
Provokimet flasin vetë.
Në këtë fushë të mejdanit çdo gjë është e mundur.
E pabesueshme, por e mundur.
Ne të shqiptarhanes nuk e njohim mirë historinë tonë.
Historinë e kemi të shkruar nga kënga mashtruese.
Për ta bërë mjegull e mjegull.
Në vend të njeriut të ditur e të mirë, për të na prirë, gjithmonë e kemi qitur njeriun e dhunshëm e të egër nga fama e rrejshme.
Në këtë botë, pa asnjë qëllim.
Me një demokraci të dhunshme.
Kur asgjë reale nuk është reale.
Nuk thuhet kot: njeriu është i pakuptueshëm.
Si nuk po e kuptoni.
Ku po e sheh ti se ka ligje?
Do të ishte mirë po të kishte ligje.
Mrekulli pas mrekullie...

6.

Shpesh më është dashur t'i kthehem pasqyrës, për ta ruajtur gjakftohtësinë.
Në kujtimet e mia edhe lirinë po e përjetojmë si kohë lufte.
Këtë skenar të një situate të keqe shpesh e shohim si ëndërr të frikshme.
Nuk e kam të qartë pse.

Besim s'kam as në tokë e as në qiell.

Për trimërinë tonë, pasqyra e ditëve tona qeshi.

Nuk është e lehtë për ta kuptuar a ka kufi a s'ka kufi.

Nga pritja e gjatë, njeriut iu ka zbutur gjaku.

Pyeteni zjarrin.

Përfundimisht hirin.

Nuk po më kujtohen shekujt.

Po kthehem aty ku isha.

Me një lidhje gjaku ku mund të shkosh më larg?

- Pas çdo lufte, njeriu harron se ku e ka vendin. Mendon se iu ka afruar Zotit, -

si në shaka më tha Dervishi që flinte nën Urën e Vezirit.

Pas ëndrrës dhe ëndrrës me vizion të qartë, njeriu me vlera kërkon diçka që i kujtohet.

Për moralin njerëzor.

Hiq më larg se sot "Njeriu e ka harruar fjalën e vet për rifitimin e anës njerëzore që e ka humbur".

7.

Si tregtarë kufijsh.

Si tregtarë flamujsh.

Në krah të majtë me djallin.

Njeriu dy herë nuk e sheh veten të njëjtë.

Nga shqetësimi kërkon të gjejë një dëshmitar.

Kur gjërat vijnë e shkojnë me kohën e vet.

Pa ditur e pa dashur.

Mos më tregoni asgjë.

Tani nuk po e kuptoj as vetë.

Çfarë planifikimi po bën njeriu.

Pyeteni egoizmin.

Me sa po shoh, nuk do ta kemi të lehtë.

Njëqind vjet nuk janë pak.

E tani çka për miletin.

Skifteri rrëmbeu një pulë.

Kur dita është ditë e nata natë.

Më vjen të vendos të mos pi kafe e të mos shoqërohem me patriotët mashtrues, e as me idealistët e pashpresë.

Të vdekur e të harruar.

Kjo përpjekje, për ta ruajtur drejtpeshimin edhe në pikë të ditës kërkon fener.

Nga zhurma që bën fama.

Me fatin që s'ka punë me fatin.

Interpretimin e ëndrrave e kemi harruar.

Edhe kur qëllon rrëfeja.

Edhe kur jeta duket e pashpjegueshme.

Pashë një gjarpër.

E luta Zotin të isha në ëndërr.

Frika e nata udhëtojnë bashkë.

Kur nga nata pa hënë nuk shohim asgjë.

8.

Në gazetën zyrtare botohet një njoftim ku thuhet se njeriu është i lirë

të mendojë e të veprojë.

Duart i ka të lira të bëjë çka të dojë.

Në moshën e kërkimeve, Ylli i Bardhë më tha:

"Rreziku është rrezik, kur njerëzit e humbin një pjesë të trupit,

matematika nuk e kupton anatominë e njeriut."

Kush e bindi Sokratin për ta pirë helmin: djalli apo njeriu?

Meqenëse nuk po na kujtohet fillimi as fundi, as fytyrën nuk e kemi si fytyrë.

Larg e afër po i përshtatemi mashtrimit.

Hap pas hapi nuk po e kuptojmë se çfarë pazari po bën jeta me vdekjen.

Kjo pyetje e ngjashme me krrokamën e korbit ende po kërkon përgjigje.

Për ta hequr qafe frikën, njeriu është aq i ndryshëm, aq i besueshëm,

saqë nuk e kupton më as vetveten.

I mbyllen sytë.

Nuk e di se çka po ndodh.

Dikur jeta i duket se ka qenë më e mirë.

Tani çka na ka kapur sikleti.

Le të na kujtohet "Heshtja e armëve".

Futjani lapsin.

Jemi në kohën e kohërave që nuk kuptohen.

9.

Njeriu që është në duar të natyrës, tani, si duket, po shkon kundër natyrës.

Me djallin që e ka qitur përpara.

"Njeriu është kafsha e parë që e ka krijuar mjedisin e vet.

Por, ironikisht, ai është edhe kafsha e parë që në tokë, në këtë mënyrë

po e shkatërron vetveten".

Shpirt, nuk është çudi, kur flas më shiko në sy.

Nuk jam i pakuptueshëm.

Mund të mos pajtohemi për interesa personale.

Gjithmonë na ka ndjekur keqkuptimi.

Nuk ka më rregulla.

Konkurrenca është e madhe.

Për të bërë jetë të qetë e të rehatshme, nuk pyetet dy herë.

Liria nuk vjen si dhuratë.

Është trupi ynë.

Në dorën e saj e kemi jetën.

Duke e pyetur veten kush jemi.

Nga Shkodra, në Shkodër.

Nga Vlora, në Vlorë.

Nga Prishtina, në Prishtinë.

Kur më së shumti i kemi besuar, në këtë botë të Bjeshkëve të Nemuna nuk lamë gjë pa thënë për njëri-tjetrin.

Mirë u pafshim, pa maska...

Njeriu e ka humbur shkëlqimin botëror!

Prishtinë, prill 2020

KUJTIMET E KATERINËS (HESHTJA DHE MIZAT)

tregim nga

Liridon Mulaj

Katerina hoqi përparësen me kuadrate të kuqe që mbante rreth belit sa herë gatuante dhe lugën e drunjtë e përplasi me vrundull brenda tiganit të mbushur me salcë që ziente si llavë. Dy miza të mëdha që lajmëronin ardhjen e verës silleshin mbi kokën e saj dhe zukatjet e tyre grricëse i shkaktonin një bezdisje të lodhshme e cila u pasua nga një mpirje e lehtë e trupit, e ngjashme me një kurth nervash dhe indesh. Iu kujtua si nëpër ëndërr ajo fjali e hershme dalë me frikë nga buzët e mbesës së saj, Antonias, thuajse dyzet e pesë vjet më parë dhe trupi iu drodh sërish si dikur. "Halla Nina, pse bërtasin mizat kur jemi vetëm?" - i jehoi zëri i largët fëmijëror i mbesës së saj dhe ashtu e topitur e plot pezëm u shemb mbi divan. E fokusoi shikimin në një pikë dhe si një film i përshpejtuar i kaluan nëpër mendje çastet e jetës së saj që, si në një humbëtirë të thellë, e kishte përplasur herë pas here, padrejtësisht, në shkëmbinjtë thikë të mprehtë të fatit. Fati i saj kishte qenë i paracaktuar që në vogëli dhe prej asaj kohe kur mbi të kishin rendur fatkeqësitë njëra pas tjetrës, ajo ishte rrekur të gjente domosdoshmërisht lidhjen shkakësore të tyre me mizat. Këto të fundit jo si shkaktare të fatkeqësive. Më shumë sesa ndjellëse të tyre, si vrasëse të heshtjes që kishte pasuar në jetën e saj qysh pasditen e asaj dite të errët të dyzet e pesë vjetëve më parë. Bezdisej, frikësohej dhe një lloj krupe e neveritshme e përshkonte gjithmonë nën efektin e zukatjeve të tyre. Këtë efekt i jepnin mizat kurdoherë që ato ktheheshin në pragstinë të verës, derisa mësohej me zukatjen e tyre, ashtu siç kishte tentuar të mësohej dhe të pajtohej me të shkuarën e saj të trishtë, mbushur me zukatje e dhimbje, me vetmi e braktisje.

U ngrit vrikthi nga divani, fiku sobën mbi të cilën ende valonte salca me ullinj dhe mori për nga dhoma e gjumit. Hapi kanatat e raftit me forcë dhe prej varëses mori një shall të lehtë si lahur të zi dhe e hodhi mbi supe. Hoqi lidhësen që mbante flokët dhe me duar i shpupuriti disa herë, derisa u dha njëfarë forme. Mbathi këpucët dhe para se të dilte, i hodhi edhe një sy sobës së fikur, ku llava e salcës tashmë kishte krijuar një shtresë koreje të trashë dhe mizat e mëdha, lajmëtaret e zagushisë së afërt, ende fluturonin mbi banak. Doli nga apartamenti dhe përplasi nga pas me forcë portën e rëndë. Zbriti shkallët ngadalë duke u mbajtur pas hekurave anësorë dhe në fytyrë ndjeu t'i ravijëzohej një frikë e beftë, shpërfytyruese, sikur nga pas e ndiqte ndonjë hije. Frikë e cila rikthehej herë pas here nga prania e mizave dhe kujtimeve që lidheshin me to si fije të trasha të pandashme. Ajo grua e cila në gjithë jetën e saj nuk kishte ndier frikë nga asgjë, as nga hija e maleve të thepisura në të cilat ishte rritur, as nga zakonet e traditat imponuese të zonës ku ishte lindur dhe as nga vdekja e trajtat e saj të përbotshme, kishte pasur vetëm një frikë e cila, krejt si e destinuar për t'u jetësuar, e kishte shuar me mbërritjen e saj dhe prej asaj dite Katerina kishte hequr dorë nga të pasurit frikë. Frika është si errësira së cilës në vogëli i trembemi, e veshim me lloj-lloj përfytyrimesh dhe kur e gjejmë guximin ta sfidojmë, atëherë kuptojmë se krejt çka fshihet pas saj është një mirazh i dhimbshëm dhe joshës. Një frikë e shkurtër të cilën nëse arrin dhe e kapërcen, atëherë fiton imunitetin e të mospasurit më frikë dhe të mosdorëzuarit para ngjarjeve të veshura me errësirë dhe dhimbje. Dhe kthehesh në njëfarë qëndrestari stoik ndaj çdo ndjenje të gjallë. Ajo që në vogëli, kërthi ende pa mësuar të flasë, kishte ndier se mbi çdo dashuri, edhe asaj të nënës, babait apo çdo qenieje të gjallë, kishte qenë dashuria për të vëllain. Ai djalosh me flokët e hedhur mbi ballë, me sytë jeshilë dhe lëkurën e bardhë, kishte qenë imazhi i jetës së saj. E kishte dashur me një forcë të pakuptueshme, forcë e cila rritej me rritjen e Katerinës dhe që ditë pas dite forconte në të mrekullinë që lind kur në jetën e gjithsecilit është dikush, një qenie e gjallë që i jep kuptim botës. Por më vonë gjithçka kishte marrë fund dhe ajo botë e plotësuar, të cilën Katerina e kishte zbuluar në praninë e të vëllait, ishte thërrmuar. Dhe as prania e prindërve apo e mbesës së saj s'kishte qenë kurrë motiv për të rindërtuar një tjetër botë të ngjashme përreth saj.

Doli në rrugë. Picërroi sytë nga drita e mjegullt e pasdites dhe një erë e lehtë iu mbështoll nëpër flokë dhe ia ngriti lart në ajër thekët e lahurit që kishte hedhur mbi supe. Dielli në ikje i pasdites po i linte vendin muzgut ngjyrëvjollcë dhe disa re të zbehta si pambuk i shprishur po fashiteshin në

cep të qiellit. Ajri i lagësht me aromë deti i ngacmonte hundët dhe kurorat e pishave të vjetruara tundeshin si të dehura mbi bulevardin e gjerë, ku automjetet e shumta derdheshin me shpejtësi drejt destinacioneve të tyre. Dritat e ndezura depërtonin në horizont dhe i falnin atij një zbardhëllim të paqtë. Katerina po ecte në drejtim të makinave dhe ndiqte me hapa të shpejtë turmën me njerëz që e rrethonin në atë ecejake të çuditshme. Ngjante si një e huaj mes tyre, krejt ndryshe në atë shpërqendrimin klasik të një zonje të rregullt dhe të kuruar, e pavetëdijshme për vendin ku ndodhej apo sytë që e vrojtonin me njëfarë admirimi të fshehur. Si kaloi qoshen e pallatit ku banonte, u drejtua për nga parku, i cili ndodhej në anën e pasme të pallatit, në mes të një korije të krijuar artificialisht që shtrihej deri poshtë rrëzë detit. Zbriti disa shkallë të mëdha, eci për pak në rrugicat me pllaka të ndara dhe pasi u gjend poshtë një pishe të re, u ul në një stol të lyer me bojë të bardhë. Atypari dy pëllumba po çukisnin njëri-tjetrin nën flatra derisa u lodhën dhe më pas, të bezdisur nga kalimtarët, fluturuan duke ndjekur njëri-tjetrin në ajrin me aromë deti. Një mesoburrë me flokë të gjatë e të çrregullt luante në kitarë i ulur në një baule prej druri dhe me një pamje hokatare lëvizte me të shpejtë kokën majtas-djathtas. Njerëz të kapur për dore ecnin të pashqetësuar, herë-herë me kokën lart, herë të qeshur e herë të pagojë. Vogëlushë që bërtisnin dhe arrakateshin mes tyre me një përçmim naiv ndaj përrethësisë dhe më pas përqafoheshin dhe qeshnin me shpirt duke goditur njëri-tjetrin në qafën e djersitur nga lodhja. Katerina mbështolli krahët në gjoks dhe sytë i hodhi matanë në det, mbi një varkë me direkë të gjatë, mbi të cilën ishte ngërthyer një velë e bardhë si copë simetrike prej reje. Veshët i buçisnin dhe zukatjen e mizave i bëhej sikur e kishte ende pas veshit. Iu kujtua ajo fjali të cilën Antonia, mbesa e saj, e përsëriste shpesh në ato kohë të largëta që ruheshin brenda saj si testament i përjetësisë. Lëshoi një ofshamë të lehtë dhe mendja pashmangshmërisht, u kthye vite më pas. Atë pasdite të ftohtë nëntori ku së bashku me nënën e saj kishin shkuar për të mbushur ujë. Katerina sapo kishte mbushur të shtatëmbëdhjetat dhe shpesh e ëma e mburrte për fizikun e saj të gjatë, për flokët e errët gërshet dhe i gëzohej dashurisë së fëmijëve të saj. Vëllai i Katerinës shërbente ushtar në kufi dhe Katerina jetonte me prindërit, bashkëshorten e vëllait dhe mbesën e vogël dyvjeçare, Antonian. Iu kujtua ajo pasdite e cila kishte qenë e fundit për të si njeri i vërtetë, e lumtur dhe pa brenga e dhimbje mbi vete. Aty nën kroin e fshatit, me shtambë në dorë, Katerinës dhe nënës së saj i ishte dhënë lajmi se të birin ia kishin vrarë në kufi. Kaq u mor vesh, rrethanat mbetën mister. Katerinës i kujtohej vagullt nëna e rrëzuar përdhe, më pas britmat e kunatës dhe fytyra e trembur për vdekje e së mbesës. Më pas, errësirë, të fikëtit e saj të herëpashershëm, varreza, prifti i fshatit me frakun e zi, psalme lutjeje, britma, shi dhe një kryq i drunjtë i gdhendur me emrin e të vëllait dhe datat e lindjes e të vdekjes të ndara me një vizë të shtrembër, aq të thelluar sa e lejon druri i lagësht. Pas vdekjes së vëllait kishin pasuar ngjarje të tjera të kobshme. Në krye të vitit bashkëshortja e tij kishte ikur te njerëzit e saj, duke lënë Antonian nën kujdesin e Katerinës. Dhimbja dhe lotët e nënës, ofshet e babait dhe dihatjet e tij nga dhimbjet e shpirtit natën vonë në kthinën prapa shtëpisë prej guri, të gjitha po i kujtoheshin në atë moment Katerinës me një përpikëri të qartë si një film i kthyer mbrapsht me shpejtësi. Iu kujtua edhe dita kur mamaja e saj, me një shishe ujë fshehur nën sqetull, doli nga shtëpia me vrull dhe u nis për nga varrezat. Më vonë mori vesh se e veja e të vëllait martohej atë ditë dhe mamaja e Katerinës kishte shkuar në varreza për të lagur me ujë

varrin e të birit pasi thuhej se, kur të vejat e të vdekurve martohen, u kallen varret. Të gjitha iu kujtuan, edhe vdekja e mamasë në krye të vitit, edhe e babait pas pak kohësh, edhe shtëpia në të cilën asokohe kishin mbetur vetëm Katerina me të mbesën, edhe fjalët e saj thënë me kaq trishtim e frikë në një natë të vonë e të ngrohtë pranvere, kur shtëpia ishte mbushur me miza dhe Antonia e vogël, e shtangur nga ajo heshtje tronditëse, kishte pyetur Katerinën me vaj të fshehur nën buzë: "Halla Nina, pse bërtasin mizat kur jemi vetëm", edhe heshtja e zgjatur e saj që fshihte nën vete lotët e ngurtësuar dhe tmerrin e një jete të ngërthyer fatalisht nga fati i keq. Brenda saj kishte vdekur dëshira për t'u ringritur dhe në këtë padëshirë ajo shikonte një mefshtësi të përhershme dhe të vetimponuar të qenies së saj. Dhe jeta i përshfaqej si një shteg i ngushtë dhe i pakuptimtë të cilin duhet ta ndiqte somnambul, e detyruar nga prezenca e saj e pavullnetshme në botë. Ajo merrte frymë, ndaj duhet të jetonte dhe forca e saj për ekzistencë gjendej mbi këtë qëllim minimal, te frymëmarrja e saj si veprim i natyrshëm dhe jo i varur prej saj. Më vonë ishte zhvendosur në qytet ku, së bashku me Antonian, kishin marrë një shtëpi të vogël në të cilën Katerina jetonte ende edhe sot, ndërsa Antonia në të njëzetat e saj kishte njohur një djalë dhe së bashku ishin arratisur drejt fatit të tyre, duke e lënë hallë Ninën të vetme. Kishte tentuar disa herë të gjente dikë për të kaluar jetën, një mashkull me histori të njëjtë apo thjesht një partner për të mos e shtyrë jetën vetëm, por fiksimi i saj absurd për të mos pasur fëmijë e kishte shpënë gjithmonë në përfundime fatale. Katerina e kishte shpallur veten si të padenjë për rolin e nënës dhe e kishte bindur veten për këtë vendim të drejtë, vendim i cili i kishte shkaktuar dhimbje dhe i kishte sjellë pasoja të mëdha. Në martesën e parë bashkëshorti i kishte gjetur nën dyshek tableta kundër shtatzënisë dhe asaj i kujtohej dita dhe çasti kur ai me valixhet e mbushura kishte ikur duke bërtitur shkalleve "Ti je e çmendur" dhe duke e lënë Katerinën të vetme teksa çirrej në një vaj të pangushëllueshëm. Ndërsa në tentativën e dytë ai e kishte braktisur pa lënë asnjë letër apo pusullë. Ishte zhdukur pa thënë asgjë, siç zhduket errësira pas një nate të gjatë në prag agimesh të kthjellëta. Katerina nuk kishte fajësuar askënd, përveçse veten. Kishte vendosur ta shkëputse fillin e riprodhimit duke mos dashur të përcillte dhimbjen e saj te krijesat e reja, të pafajshme dhe të pambrojtura nga ndikimet e forta, të cilat krejt natyrshëm dhe pa vetëdije përcillen nga nëna te fëmija në procesin e ushqyerjes me gji, në zërin e dridhur të ninullave apo vajin e fshehtë natën nën batanije, ku fëmijët sado të vegjël kanë aftësinë ta njohin dhe ta shquajnë trishtimin e nënës dhe gjithashtu ta ngërthejnë në kujtesë përjetësisht.

Katerinën e kishte marrë malli për mbesën e saj dhe brenda vetes e vuante braktisjen e paqëllimshme. Braktisje e kushtëzuar nga përballjet me jetën. Antonia tashmë ishte e martuar, kishte dy fëmijë dhe ndiqte karrierën si mjeke në një tjetër shtet. Ishte vënë pas karrierës me vrull dhe ishte përhumbur në rrjedhat e saj si çdo njeri i cili nuk kupton që, sado i lumtur të jetë në jetë, harron se ekziston një ditë në të cilën detyrohet të dorëzojë gjithçka. Dita e shkëputjes nga vetvetja dhe rendja e pavullnetshme drejt fundit. Si në ato udhëtimet me tren ku, pasi ke mbërritur në destinacion, të zbresin pa dëshirë dhe të detyrojnë të hipësh në trenin e kthimit për në vendin ku u nise, tashmë i plakur, pa dëshira dhe me një boshllëk të madh në zemër për të gjitha çastet e humbura dhe fjalët e pathëna, të cilat mbase ashtu të vockla dhe pa rëndësi mund të kishin ndryshuar çastin e atyre që kemi për zemër dhe që shpesh ose gjithmonë i harrojmë. Iu kujtua edhe ëndrra me të vëllain, ku pas gati tridhjetë vjetësh, kur Katerina ishte grua në moshë, e kishte parë në ëndërr të drobitur, të lodhur dhe pa kuptuar, ai i kishte bërtitur së motrës dhe ajo ishte zgjuar nga gjumi duke qarë nga malli për të. Njëjtë si në vogëli, kur ai e qortonte për gabimet dhe Katerina e vogël qante pa zë dhe pas një copë kohe në vaj, i afrohej të vëllait dhe me pendesë, varte kokën e saj mbi sup të tij në shenjë pajtimi. Ajo ëndërr Katerinës i kishte ngjarë me një mesazh apo njëfarë qortimi për largësinë e gjatë me të mbesën, Antonian, edhe pse ajo kishte tentuar disa herë ta bindte që të vinte për t'u takuar dhe ishte përballur me justifikimet e së mbesës, punë dhe shkaqe karriere. Ndaj, e bindur se ishte gati joetike ndërhyrja në jetën e së mbesës, ajo kishte zgjedhur heshtjen dhe kredhjen në rutinën e përditshme të jetës së saj të vetmuar.

Sirena e anijeve që ankoroheshin në portin përballë e zgjoi Katerinën nga përhumbja. Një fllad i freskët i kishte depërtuar nën lëkurë dhe qielli i nxirë nga errësira ishte mbushur me yje të zjarrta. Parku pothuaj ishte boshatisur dhe fenerët e ndezur që e ndriçonin, krijonin atë dritë artificiale të nevojshme për këtë park të vetmuar në natë. Ndjeu se duhej të kthehej në shtëpi. U ngrit nga stoli, mbështolli kokën me lahurin dhe u nis drejt apartamentit. Derën e hapi me përtesë, hodhi shallin mbi divan dhe sytë i shkuan në tiganin me salcën e zier e cila kishte marrë një ngjyrë të fortë vishnje. Mizat ishin zhdukur dhe Katerina, e lodhur nga kujtimet, u hodh në divan. Iu bë sikur ndjeu sërish një zukatje, ngriti kokën paksa nga mbështetësja, por kuptoi që kishte qenë thjesht zhurma që krijonte pavetëdija e saj e ngarkuar me zukatje dhe britma, me klithma dhe vaje të cilat herë pas here zgjoheshin dhe ia kujtonin të shkuarën e largët. Sërish u shtri dhe duke rregulluar nënkresën, u paqtua me idenë se zukatjet do të riktheheshin të nesërmen sërish dhe se mizat, si gjallesa të cilat i ngjallnin krupë, do të ishin aty përgjatë gjithë stinës së verës, por fundja ajo do të mësohej sërish me praninë e tyre, siç ishte pajtuar me fatin e saj qysh në vogëli.

ZEMËRIMI I BOTËS

poezi nga

Sali Bashota

KUR E KAPËRCEJMË FRIKËN

Vetëm në shpirt frymon besimi
Thonë të gjithë ata që besojnë
Shenjat e prekjes me dorëza të bardha
Ngulfasin vetminë në hyrje të heshtjes
Vetëm në shpirt frymon dashuria
Përtej asaj çka mund të ndodhë
S'di askush pos e panjohura
Që rrethon zjarrminë e kokave
Të mos plasin nga monotonia e jetës
Kur e kapërcejmë frikën
Ashtu të këputur nga inati i errësirës
Vetëm në shpirt frymon lumturia
Pajtohemi të gjithë si engjëj të bukur
Vetëm në shpirt frymon besimi

ZEMËRIMI I BOTËS

Lufta e Parë Botërore
Përshiu gati tërë botën
Njerëzimi u zemërua me vetveten
Dhe humbi milona njerëz
Me luftëra të çmendura për sundim
Me vrasjen e shpirtrave të pafajshëm
Çuditërisht nuk u mësua me vdekjen
Pastaj erdhi Lufta e Dytë Botërore
Prapë lufta e njeriut kundër njeriut
Asgjë nuk u harrua as frika
Në mileniumin e ri
U bë shkatërrimi i kullave binjake
Prapë nga dorë e ligë e njeriut
Bota e shkundë tmerrin e vet
Në kontinentin e saj më të fuqishëm
Befas erdhi virusi me emrin e vet
Vetëm nga njëra gjymtyrë e njeriut
Njerëzimin e zuri gjumi nga e padukshmja
Befas erdhi e panjohura e zezë
Që mund të zhduket vetëm me të bardhën
Kur të gjithë ikim nga njëri-tjetri vetëm dy metra
Përjashtohen vetëm njerëzit e Hipokratit
Që jetën e mësojnë të mos vdesë
Duke shpëtuar shpirtra të pafajshëm
Me optimizmin e dashurisë

NJË ORË E GJYSMË LIRI

Shteti ynë i dashur
I respekton të drejtat e njeriut
Në çdo njëzet e katër orë
Liri falas një orë e gjysmë
Me u shastisë duke shëtitur vetminë
Kur rendi përcaktohet shumë saktë
Nga numri i parafundit i letërnjoftimit
Asnjë sekondë më tepër
Në çdo të tretën ditë
Ndërron orari i lirisë
Me dekret për të panjohuren
Që mund të na gjejë kudo
Edhe në ëndrra të bukura
Edhe pa ia ofruar dorën askujt
Vetëm për ta kënaqur mallin e syve
Në çdo njëzet e katër orë
Liri falas një orë e gjysmë
Mjafton sa për ta qetësuar frikën
Mjafton sa për t'i shëtitur shpirtrat
Nëpër trotuaret e qytetit bosh
Derisa prapë t'i vijë rendi secilit
Për t'u bërë i lumtur me vetveten
Si njerëz të shndërruar në numra
Në çdo njëzet e katër orë

RREGULLAT E VETMISË

S'është dashur të mërziten ëndrrat
Ashtu siç thonë poetët
Pse jeta ka kaq shumë dhimbje
Kur vjen e diela tjetër e ngujimit
Me plasë ecja në karantinën e vet
S'është dashur të mërziten as përqafimet
Ashtu siç thonë poetët
Me pa si vjen pa paralajmërim dashuria
Me çelësin e pritjes së shkrumbuar
Vetëm deri tek dera aman
Kur çmendet edhe zjarri i buzëve
Pa kafenë e mëngjesit në "Symphony"
Pa ia shtrënguar dorën miqve të dashur
Pa ndërruar as një fjalë për poezinë
Në mbrëmjet e vona në "Amaro"
S'është dashur të mërziten as zogjtë
Pse qielli hatërohet me heshtjen e vet
Si toka me mungesën e hapave të rëndomtë
S'është dashur të mërzitet
As qetësia e dëshpërimit të shpirtrave
Ashtu siç thonë poetët
Së paku për rregullat e sakta të vetmisë



AFATI I FRIKËS

Ndoshta vetëm për disa ditë
Mund të shtyhet afati i frikës
Derisa të ngjallet optimizmi
Në shpirtrat tanë
Dhimbjet s'duhet të pëlcasin
Kur i vjen radha lotëve
Me ikë nga fytyrat e mërzitura
Në këtë kohë pandemie
Ndoshta vetëm për disa ditë
Mund të shtyhet afati i frikës
Derisa të zgjohet dashuria e vërtetë
Në besimin e njerëzve
Kur duart duan të çmallen me prekjen
Mbi trupat e ndaluar
Të çmallen edhe me gjysmën e përqafimit
Sa herë botën e mbulon dhimbja
Ndoshta vetëm për disa ditë
Mund të shtyhet afati i frikës
Me orën e saktë të durimit
Frymë kush merr më së shumti
Në të dy krahët e ëndrrave
Kur hapen shtigjet e fatit
Uji përdoret vetëm si ilaç i etjes
Ndoshta vetëm për disa ditë
Mund të shtyhet afati i frikës
Aty ku do të zgjohet përgjithmonë buzëqeshja
Në qiellin pa asnjë re të zezë

VDEKJA ME EMËR TJETËR

Kjo vdekje ka emrin koronavirus
Tashmë bota e di ç'është zemërimi
Mbajeni mend zgjatjen e dorës
Edhe pa thënë asnjëherë tungjatjeta
Pa prekur buzën me buzë
Pak muzikë për botën e gjallë
Për shembull "Dasma e Figaros" e Mozartit
Mund të jetë zgjedhja e çastit
Pa i çmendur fluturat në dhomë
Kjo vdekje ka emrin koronavirus
Do t'ia nis një letër Çarl Bukovskit
Ta pyes për poezinë e tij "Jeta e Borodinit"
Por edhe për farmacistin Borodin
Për një fjalë si vjen shpëtimi
Me u çmendë më pak muzikë Mozarti
Deri në fund të dhimbjes
Në tokën e thatë pa asnjë pikë shi

DITA BOTËRORE E POEZISË NË VITIN 2020

Sot poetët festojnë dashurinë e tyre
Në vetminë e realitetit të botës
Ëndrra e parë si zbutja e melankolisë
Pastaj vizatimi i dashurisë në secilën zemër
Vetëm me ngjyra të bardha
Asnjëri s'është në amfiteatrin e ndjesive të bukura
Sot poetët nuk festojnë ditën e poezisë
Aty ku zgjohen duartrokitjet e ëndrrave
Bota përkundet me përjetimin e dhimbjes
Njerëzit vdesin nga e panjohura
Sot poetët nuk festojnë ditën e frymëzimit
Merren vesh vetëm për dashurinë
Që ta ruajnë në shpirtrat e tyre
Për veten dhe për të tjerët

(Marrë libri "Pëshpëritja e agonisë", PEN Qendra e Kosovës, Prishtinë, 2020)

MO YAN
DUKE DËGJUAR "KUAKJEN E BRETKOSAVE"

Titulli i romanit "Bretkosa" është shkëputur nga një poemë në Xin Qizi, e titulluar "Udhëtim nate në Huansha". Kjo ishte një pjesë që unë e dija që nga fëmijëria. E dija dhe nuk e harroja, pikërisht ngaqë "Duke dëgjuar kuakjen e bretkosave" nga kjo poemë ishte e lidhur fort me kujtimet e mia të fëmijërisë. Njerëzve që kanë lexuar romanet e mia, duhet t'u kujtohet që unë dikur kam përshkruar kuakjen e bretkosave, por me siguri që nuk e dinin fobinë time ndaj bretkosave. Është normale dhe e arsyeshme që njerëzit të kenë fobi nga gjarpri apo kafshët e egra, por që të kenë frikë nga bretkosat, të cilat janë të dobishme për njerëzit dhe, madje, shërbejnë edhe si ushqim për ta, kjo duket krejt e pazakontë dhe e pajustifikuar. Sapo sjell nëpër mend sytë e tyre të zgurdulluar dhe lëkurën e qullët, më rrëqethet mishi e më çohet mishi kokërr. Përse kam frikë? As vetë nuk e di. Ndoshta është pikërisht kjo një ndër arsyet që unë e kam titulluar "Bretkosa" këtë roman.

Ashtu siç shkruhet edhe në roman, unë me të vërtetë kam një hallë, është mjeke gjinekologe që ka shërbyer për shumë e shumë vite. Mijëra fëmijë në Gaomi Dongbei Xiang kanë ardhur në jetë me ndihmën e saj. Por po ashtu kanë qenë jo pak fëmijë, që kanë vdekur në duart e saj pa e parë dritën e diellit. Halla e romanit natyrisht që ka shumë ndryshim me hallën reale. Halla reale është vetëm prototipi që më ka frymëzuar në krijimtarinë time. Ajo tani jeton në fshat, ka një tufë nipërish e mbesash dhe bën një jetë të qetë e të paqtë.

Në vitin 2002, kur mora penën e fillova të shkruaja këtë roman, titullin ia kisha vënë "Pilula e larvës". Frymëzimi për këtë titull më kishte ardhur nga një lajm i botuar në një gazetë në vitin 1956: Burri dhe gruaja, para se të bëjnë dashuri, mjafton të hanë katërmbëdhjetë copë larva dhe gruaja nuk mbetet shtatzënë. Njerëzit që kanë njohuri minimale, do ta kuptojnë se sa absurde është kjo metodë, megjithatë, në atë kohë, kjo u përhap e mori dhenë. Panorama ishte shumë e ngjashme me disa metoda që lulëzuan më vonë si "pirja e gjakut të pulës", "pirja e baktereve të çajit të kuq" etj. Në këtë linjë, shkrova më shumë se njëqind e pesëdhjetë mijë hieroglife libër, por befas ndjeva se me këtë mënyrë të shkruari, pa dashur kisha rënë në rrugën e vjetër të ekzagjerimit të disa gjërave absurde, aq më shumë edhe metoda e konstruktit kishte pasur një lidhje të sforcuar e të tepruar. Kështu që e lashë mënjanë këtë dorëshkrim dhe fillova të ideoj dhe të krijoj "Lodhja për jetë a vdekje". Vetëm në vitin 2007 rifillova shkrimin e këtij libri, strukturën e ndryshova në formën e një letërkëmbimi dhe e titullova "Bretkosa". Sigurisht që unë nuk mund të isha i kënaqur vetëm nga një rrëfim i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë, prandaj pjesa e pestë e romanit u shndërrua në një dramë plot ngjyra magjike që, së bashku me kapitujt e romanit, kompensojnë njëra-tjetrën. Shpresoj që lexuesit nga këto dy mënyra të shkruari të arrijnë të kuptojnë qëllimin tim të mirë.

Është e vërtetë që Planifikimi Familjar, i cili në Kinë është zbatuar mbi tridhjetë vjet, ka ngadalësuar ritmet e rritjes së popullsisë, por po ashtu është e vërtetë se, gjatë procesit të zbatimit të kësaj "Politike shtetërore të rëndësishme", kanë ndodhur shumë e shumë ngjarje rrëqethëse. Problemet e Kinës janë jashtëzakonisht të komplikuara, dhe problemi i Planifikimit Familjar është edhe më shumë i komplikuar. Ai ka të bëjë me politikën, ekonominë, marrëdhëniet njerëzore, moralin dhe shumë e shumë çështje të tjera. Megjithëse nuk guxoj të them se ai që e ka kuptuar Planifikimin Familjar të Kinës, do të thotë që ka kuptuar edhe vetë Kinën, por nëse nuk arrin të kuptosh problemin e Planifikimit Familjar të Kinës, atëherë është e kotë të mburresh se e ke kuptuar Kinën.

Vitet e fundit ka pasur debate të forta rreth çështjes së vazhdimit ose jo të zbatimit të politikës së një fëmije të vetëm. Autorët e artikujve debatues, shumica janë personazhe serioze e me bagazh, po ashtu këto shkrime botohen nga mediat kryesore. Akoma më tej, diskutimet në internet rreth këtij problemi janë bërë mbisunduese dhe të zjarrta. Nga të gjitha këto, shihet se reflektimi dhe studimi i politikës së Planifikimit Familjar është bërë tashmë një problem i nxehtë në vëmendje të masave të gjera. Me thellimin e reformave dhe të hapjes me botën, me kalimin e ekonomisë kolektive drejt ekonomisë private, në kushtet kur qindra milionë fshatarë kanë fituar të drejtën e lëvizjes dhe të punësimit, politika e një fëmije të vetëm sa vjen e bëhet më e vështirë për t'u zbatuar. Fshatarët mund të lindin fshehurazi ose duke lëvizur nga një vend në tjetrin, ndërsa të pasurit dhe zyrtarët e korruptuar duke pranuar me qejf të gjobiten ose duke "mbajtur një grua të dytë", kryejnë lindje jashtë planit kur të duan dhe si të duan, duke realizuar kështu edhe dëshirat e tyre për trashëgiminë e brezave apo për të trashëguar pasuritë e familjes. Me sa duket, të vetmit që e zbatojnë këtë politikë janë nëpunësit e vegjël të shtetit, të cilët marrin edhe rroga të papërfillshme. Ata, së pari, nuk guxojnë të luajnë me bukën e gojës dhe, së dyti, nuk përballojnë dot shpenzimet për arsimim, të cilat sa vijnë e rriten çdo ditë. Kështu, edhe sikur të lejohen të kenë një fëmijë të dytë, ata nuk guxojnë ta bëjnë këtë.

Romani im "Bretkosa", duke përshkruar jetën e hallës, nga njëra anë pasqyron historinë dhjetëravjeçare të lindjeve në fshat, nga ana tjetër demaskon pa doreza situatën kaotike në problemin e Planifikimit Familjar të Kinës së sotme. Përballja e drejtpërdrejtë me problemet delikate të shoqërisë, ka qenë dhe mbetet qëndrim konstant imi në krijimtari, sepse, sipas meje, letërsia duhet të ketë në fokus edhe problemet e njerëzve, vuajtjet e tyre, fatin e tyre. Dhe problemet delikate, më mirë se çfarëdo tjetër, tregojnë në një mënyrë të koncentruar karakterin e njeriut.

Duke pasur si orientim qëllimin e mirë, zgjodha temën që frymëzon shpirtin krijues, ndërsa orientimi i mendimit estetik të romanit tim përcaktoi formën e tij. Ndërkohë, duke u udhëhequr nga një vetëdije e fortë e analizës së vetvetes dhe duke denoncuar gjendjen e brendshme të personazheve, unë zbuloj para lexuesve vetë zemrën time. Ky është një nga tri parimet bazë, nga të cilat jam udhëhequr unë gjatë shkrimit të "Bretkosës" dhe që do të ndjek edhe në të ardhmen gjatë veprimtarisë krijuese.

Pasi përfundova së shkruari këtë libër, tetë hieroglife vazhdonin të më peshonin rëndë në zemër: 他人有罪，我亦有罪 (Nëse dikush është fajtor, edhe unë gjithashtu jam me faj).

Pekin, 22 nëntor 2009
Përktheu nga kinezishtja: Iljaz Spahiu

SHËNIM: Këtë shkrim autori e ka shkruar si parathënie për botimin e romanit në Tajvan, në vitin 2009.

MEHMET KRAJA
UDHËZIME PËR KAPËRCIMIN E DETIT

parathënie për botimit e tretë

Dorëshkrimi këtij romani, gjatë kohës që i bëra një redakturë të lehtë tash së fundi, më mbajti në mendje një imazh, i cili, mësa duket, do të jetojë po aq sa kujtesa ime për ngjarjet dhe zhvillimet që e kanë nxitur shkrimin e tij: ora policore në Prishtinë, për shkak të demonstratave të pranverës së vitit 1981, apartamenti im në katin e pestë në lagjen e Prishtinës "Kodra e Diellit", dritarja e kthyer nga rruga dhe përball një udhëkryq, në të cilin vigjilonte një patrullë policie, për të zbatuar ndalimqarkullimin. Pamja zgjati disa muaj dhe u përsërit një vit më vonë, në përvjetorin e parë të demonstratave, kur sërish u shpall ora policore dhe shtetrrethimi.

Për shumicën njerëzve që jetonin atë kohë, mund të mos ishte krejt e qartë se kujt i bënin roje dhe me kë rrinin gati të luftonin ato patrulla policie, ngase dukej sikur ato bënin luftë me një armik të padukshëm, me idetë, me pikëpamjet, me bindjet, me idealin njerëzor, me frymën e lirisë. Gjatë atyre orëve të gjata policore dhe të ndalimqarkullimit askund nuk kishte armiq realë, ndërkohë që netët ishin tipike mesjetare, të errëta, misterioze dhe kërcënuese. Atmosfera ishte e zymtë dhe Prishtina jetonte ditë ankthi dhe terrori. Mbi të gjitha, Kosova mbante mbi vete barrën e rëndë të vasalitetit, nga njëra anë, dhe të lirisë së ëndërruar dhe të paarritshme, më anë tjetër. Ky dualizëm në qenien e saj e bënte Kosovën të përjetonte traumën më të rëndë të të gjitha kohëve: të bënte luftë me veten, me robërinë e vet shpirtërore, me vasalitetin e mendjes dhe të shpirtit, por njëkohësisht edhe me pushtimin real, i cili kërcënonte egërsisht me zhbërjen e substancës dhe të identitetit kombëtar.

Duke e ndjerë këtë atmosferë të rëndë, me t'u kthyer në apartamentin tim në lagjen "Kodra e Diellit", pas një pune gati vetëshkatërruese si redaktor i rubrikës së kulturës në gazetën "Rilindja", ndonëse jo plot tridhjetë vjeç, mbaj mend se gati ma zinte frymën dilema se si mund të nxirrej në një rrëfim letrar një gjendje e këtillë, pa vënë në veprim mekanizmat e censurës? Në të vërtetë, shkrimtarët e Kosovës tashmë e kishin fituar një lloj përvoje që, në rastin e disidencës nacionale, ta kthenin mekanizmin e censurës në një lloj vetëcensure, kryesisht përmes metaforave në poezi, ose përmes rrëfimeve alegorike në dramë dhe në prozën romanore. Historia në këtë rast nuk do të shërbente për të sjellë në vëmendje kohë të lavdishme, siç ndodhte zakonisht, por kohë të errëta dhe kërcënimin e zhbërjes së qenies kombëtare.

Që këndej, pra, mund ta kenë origjinën disa komponentë themelorë të këtij rrëfimi, të cilët, po të zbërthehen alegoritë, marrin këtë kuptim: Kosova jetonte një kohë të pushtimit dhe të pamundësisë së frikshme; jetonte një inkuizicion modern. Me autonominë e saj të nëpërkëmbur, ajo ngjante me një principatë mesjetare, e cila ishte e detyruar të njihte pushtetin suprem të mbretit, si dhe trillet ideologjike dhe represionin kishtar. Në kushtet e një luftë të pashpallur dhe në gjendje të shtetrrethimit, ajo përballej me një ushtri dhe aparat represiv, i cili nuk kishte përballë asnjë armik real, pos përbërësve identitarë të një populli, siç ishin gjuha, historia, shkrimi, eposi, gojëdhënat etj. Për të konstruktuar një rrëfim mbi këtë bazë, së pari u desh të ndërtohej konfiguracion imagjinar: një kështjellë diku jo larg detit, me sheshin dhe pallatin e princit në mes, pastaj një ushtri e huaj që e mban të rrethuar atë kështjellë, një kishë me kambanore, konaku me qelat e priftërinjve, përfshirë edhe një numër vetjesh që i bartnin zhvillimet në një hapësirë të tillë: një murg që ruan dhe lexon dorëshkrimet e vjetra, një ipeshkv që vritet, një princ vasal që i zhvillon luftërat me ndërgjegjen e vet, si dhe titullarë të tjerë të kishës; një kont spiun, një kryekomandant ushtrie pushtuese etj.. Aty është edhe atë Brokardi, emrin e të cilit mban vepra me dëshminë e parë të shkrimit shqip: "Udhëzime për kapërcimin e detit". Dhe në fund, në fjalinë mbyllëse një imazh që paralajmëron atë që do të ndodhë gati njëzet vjet më vonë: "Nëpër një natë me hënë guri i varrit m'u bë kalë dhe unë u ngrita dhe shkova në atë luftë të lënë përgjysmë".

Për të ndërtuar këtë konfiguracion imagjinar të zhvendosur aq larg në kohë dhe për krijuar atmosferën e ngjarjeve autentike, m'u desh një njohje e themeltë e periudhës së mesjetës dhe e bëmave të saj, gjithnjë duke pasur në mendje korrelacionet alegorike të asaj kohe të errët me zhvillimet bashkëkohore. Çuditërisht, pas shumë vitesh pata vërejtur se zhvillimet në rrëfimin tim, përfshirë disa ngjarje dhe personazhe të veçanta, kishte ngjashmëri të madhe me dy romane të shkruar shumë vite më vonë: "Emri i trëndafilit" i Umerto Ekos dhe "Unë jam e kuqja" e Orhan Pamukut. U ndjeva mirë, sepse kisha shkruar diçka që shpjegohet me poligjenezën në art dhe në letërsi: shkrimtarë të ndryshëm, duke përshkruar rrethana identike krijojnë vepra dhe krijime artistike që kanë ngjashmëri me njëra-tjetrën, edhe pa asnjë komunikim të mesvetshëm.

Duke marrë parasysh rrethanat politike dhe atmosferën e rënduar pas vitit 1981, pastaj përmbajtjen e romanit dhe vigjilencën e shtuar të institucioneve të censurës së fshehtë, dorëshkrimit iu krijua një vonesë për botim, me shpjegimin se titulli fillestar "Dëshmia e vitit 1332" nuk ishte "i përshtatshëm". Ndërkohë, tri vjet pas botimin në Prishtinë, më 1987, romani u ribotua në Tiranë, pa asnjë ndryshim, duke u bërë një nga veprat e rralla të letërsisë së Kosovës që i jepej lexuesit të Shqipërisë pa censurë.

Po në ato vite, me personazhin e Princit vasal dhe me zhvillimet tragjike rreth tij, shkrova dramën "Princi i hijeve" e cila fitoi në konkursin e Teatrit Popullor të Kosovës dhe më pas u vendos në skenën e këtij teatri dhe të Teatrit Popullor të Gjilanit. Shfaqja e Gjilanit mori pjesë në shumë festivale të ish-Jugosllavisë dhe fitoi disa çmime, por edhe vërejte "ideore", sepse glorifikonte të kaluarën shqiptare dhe krijonte një aluzion të papërshtatshëm me zhvillimet dhe rrethanat bashkëkohore.

Pas 35 vjetësh unë vendosa ta risjell këtë roman në vëmendje të ndonjë lexuesi të mundshëm, ndoshta jo për të rikthyer në kujtesë një kohë që nuk na duhet më, por më shumë për të dëshmuar një përvojë shkrimi pak më ndryshe dhe për të mbajtur disi më të plotë tablonë e gjithë mozaikut të letërsisë sonë në një periudhë më të gjatë kohore, e cila tashmë qëndron në kufijtë e historisë.

KUJTESA NË STRUKTURËN ROMANORE TË I. KADARESË: "DOSJA H." dhe "PËRBINDËSHI"

nga Lili Sula

Rrezatimi kuptimor i *kujtesës*, si element sendërtues i artit, përfshin të gjitha rrafshet e organizimit të tekstit dhe është i një natyre krejt të ndryshme nga kujtesa e bartur nga ligjërimi historik. Siç dihet, ky i fundit funksionon vetëm falë raporteve me kontekste të tjera shkrimi, me synim qartësimin: të shkruarit në vargje, na mëson Aristoteli, nuk e bën më pak historian dhe më shumë letrar Herodotin.

Kujtesa është kreative, ajo përfaqëson aftësinë "për të lexuar" historinë si e shkuar dhe si bashkëkohësi në veprën letrare falë kuptimeve shtesë që kon/teksti organik i veprës rrezaton dhe artikulon kujtesën vetjake të pavullnetshme si kondensim të përvojës; kujtesën si "citim" të vullnetshëm dhe të pavullnetshëm të letërsisë pararendëse; kujtesën si numër (përsëritje e leksikut, fjalive, mendimeve, koncepteve etj.), që sendërtojnë të vërtedukshmen e strukturës formale të veprës; si dhe kujtesën si kategori logjike kyç e ndërtimit të figurës (mjafton të përmendet analogjia në themel të metaforës).

Kujtesa si koncept ngushtësisht i lidhur me procesin e krijimit artistik dhe të receptimit të veprës letrare përfaqëson një proces dinamik; nëse harresa është lodhja, gjendja statike, ndërprerja e interaktivitetit, kujtesa është ndryshueshmëri, lëvizje energji, që përfshin jo vetëm "kujtimin e fytyrës së paraardhësve, po dhe vazhdimësinë e fillit ku e kanë lanë ata.[1] Sa më funksionale dhe logjike të ndërkallen figurat në strukturën tekstore, aq më fort e godasin "kujtesën" e lexuesit dhe aq më të rëndësishme bëhen si çelësa të leximit të historisë si bashkëkohësi. Arti elitar i ndërlidh organikisht këto elemente dhe ngjall kujtesën e lexuesit, duke zgjeruar ndjeshmërinë e tij intelektuale për të kuptuar më mirë bashkëkohësinë dhe të shkuarën.

Teksti letrar përfaqëson kështu një palimpsest ku shtresohen plot figura, imazhe, ide e botëpërjetime që përcillen e gjejnë vend në *palimpsestin* e leximeve e përjetimeve të receptuesit, tek i cili leximi më i ri ushtron forcë për t'i zënë vend të mëparshmit, "të vjetrit", edhe pse ka vend për të gjithë. "Palimpsesti i kujtesës është i pashkatërrueshëm, "po lexues, shkruan Bodler, të pafund janë poemat e gëzimit apo dhimbjes që janë ngulitur dalëngadalë në trurin tuaj."[2] Kujtesa trashëgohet brez pas brezi për të mos lënë në harresë shpirtin njerëzor, por për ta jetësuar e kujtuar atë në shpirtin artistik.

Shkrimtarët karakterizohen nga mënyra leximesh artistike të veçanta, që bashkojnë e shtresojnë kënaqësinë e receptimit të veprës me atë të krijuesit të artit duke artikuluar e trajtësuar shenja ligjërimore të dallueshme. Ismail Kadare shpalos në veprën e tij të gjithë dinamikën e frytshme të morfologjisë së kujtesës që dallon artin e madh.

Në rrafsh të gjurmëve që retorika e Aristotelit quan *héuresis* dhe ajo latine "*inventio*", analiza dhe interpretimi i *kujtesës* ka të bëjë me kërkimin dhe gjetjen e çelësave strukturorë që ndërtojnë veprën; sterna e kujtesës kadareane përmban, në radhë të parë elemente të leximit të autorëve antikë grekë, si: Homeri, Eskili etj., si dhe atyre latinë. Ata lanë gjurmë në botëperceptimin kadarean, duke u bërë vendimtare në procesin krijues të shkrimtarit, nga ku do të buronin rrëfime shumë komplekse. Marrëdhëniet e veprës së I. Kadaresë me antikitetin grek janë të njohura e përbëjnë një nga boshtet artistike të prozës së tij aq sa është thuajse e pamundur të analizosh e të interpretosh vepra si *Dosja H.* e *Përbindëshi*, pa marrë parasysh shtratin e letërsisë antike greke. "Kombinimi i dhuntisë narrative me intuitën e një lexuesi të jashtëzakonshëm siç është Kadare ..., shënon M. Mandalá, ... na bën të shqyrtojmë te rrëfimet e Kadaresë shenja të kujtesës së pavullnetshme" dhe të kujtesës së vullnetshme të "leximeve vetjake".[3]

Romanet *Dosja H.* e *Përbindëshi* bartin e transmetojnë te lexuesi gjurmë të qarta kujtese leximesh vetjake që përvijojnë profilin krijues të I. Kadare si shkrimtar. *Dosja H.*, u botua fillimisht si *novelë,* në të përmuajshmen "Nëndori", më 1965, ndërsa *Përbindëshi* po ashtu te "Nëntori", më 1982, në periudhën e lulëzimit të letërsisë së socrealizmit.

Të dyja veprat, *Dosja H.* dhe *Përbindëshi* janë komplementare dhe në tension të kundërt mes tyre: *Përbindëshi* është simbol i dhunës dhe censurës, kundrejt *Dosjes H.*, manifestim i lirisë shpirtërore, trashëguar nga epika popullore, gojore. Përmasa shtesë ky synon analiza e dy veprave ka të bëjë me treguesin identitar, artistik e nacional që ajo përcjell për të shkuar te liria natyrore e kombit, që nuk i bindet ligjeve diktatoriale të Përbindëshit antik/modern.

Në qasje binare, po veçojmë dy plane rrëfimtare: ai fiksional dhe studimor.

Plani i fiksionit bartet shpesh në atë të studiuesit shkencëtar: ai i doktorantit Gent Ruvina (*Përbindëshi*) dhe dy studiuesve irlandezë Vili e Ruth (*Dosja H.*). Në të dyja këto plane ka rimarrje të letërsisë antike greke, përmes dy elementeve çelës të retorikës së tekstit: kujtesës si citim dhe kujtesës si veshje alegorike e simbolit (*Kali*, *Dosja*).

Botimi i parë i *Përbindëshit* (1965), bart një element paratekstual të antikitetit latin, që nuk u ruajt edhe në botimin e romanit si libër më vete. Shmangia e paratekstit, në botimin e romanit, zgjeron shtegun artistik të rrëfimit e të receptimit sa thellon penetrimin në qytetërime e kultura të lashta për t'i dhënë përmasë universale ligjërimit: "Mos i besoni kalit/ Në qetësinë e natës vini veshin,/ A nuk dëgjoni një trok të largët, të shurdhët?/ Nga thellësitë e errëta të kohërave drejt/ Qyteteve tona/ Po trokon një kalë:/ Kali i Trojës; Virgjili, viti 25, p.e.s.

Trokëllima e Kalit të Trojës hap portën e receptimit të lexuesit dhe vendos shenjën e barazimit midis *Kalit* e *Përbindëshit* e për të shtuar më pas në këtë barazim edhe *Furgonin*, pra duke ndërfutur forcën e diktatit në tre mekanizma kujtese letrare kohësisht të largëta, që artikulojnë e përshkallëzojnë nën trysni të vazhdueshme shoqëritë e mbyllura diktatoriale.

Të dy romanet sjellin në bashkëkohësi "enigmën homerike" përmes shenjave tekstore të kujtesës së vullnetshme në rrafsh të letraritetit dhe në rrafsh të profilit kritik të autorit. Misteri i *homerizimit* të eposit të *Dosjes H.* dhe mëdyshja për praninë e *Kalit* bashkëshoqërohet me çështjen e kujtesës, me atë trashëgimi brezash njerëzorë e kryeveprash artistike që bashkëlidhin rrëfimet e dy romaneve në një tërësi shtresimesh në trajtë palimpsesti. Kujtesa, si mekanizmi më i rëndësishëm, që formëson dhe ruan identitetin kulturor e nacional të shoqërisë sonë moderne, është përvijuar në trajtën e kujtesës kolektive, të artit të veshit, kujtesës orale të eposit popullor, monumentit të kulturës sonë artistike, te *Dosja H.,* kundrejt kujtesës për të mos harruar, atë "vjetërsi të botës", Kalin e Trojës, që transmeton forcën e gjithkohshme të diktatit ndaj individit dhe shoqërisë, te *Përbindëshi*.[4] "Në mendjen e tij thirrjet e kalamajve të provincës: Helenë e Trojës, ashtu siç ia kishte treguar ajo vetë, së bashku me idenë e bukuroshes së fjetur që zgjohet pas tri mijë vjetësh (natyrisht, e ftohtë tashmë), përpiqeshin të mbrunin një mendim... (*Përbindëshi*, f. 60).

Dosja H.[5] (asocion me një palimpsest) përmbledh një tërësi regjistrimesh të epikës sonë popullore, si dhe hulumtimet e dy "homeristëve" irlandezë, doktorantit Maks Roth e Vili Norton mbi çështjen homerike, e cila ndërthuret me gjykime për "platformën e një parauniversi të përbashkët greko-iliro-shqiptar. Kombësia irlandeze[6] e studiuesve jo rastësisht përkon me nacionalitetin e autorit të Uliksit, si për të përligjur gravitetin dhe rrezatimin e mitit dhe kulturës europiane, të bindjes autoriale për vlerën e eurocentrizmit në larushinë e kulturës botërore. Ngjarjet e *Dosjes H.* morën shkas nga një takim i shkurtër, në Ankara, në fund të viteve `70, të shkrimtarit I. Kadare me dy amerikanë Milman Parry e Albert Lord, të cilët kishin qenë në Shqipëri për të studiuar gjurmët e eposit homerik. Misioni i dy studiuesve Maks Roth e Vili Norton, që "u ngjan dy donkishotëve të trishtë", pikëtakon, kryqëzon, shtreson e shtegton nga njëra mitologji tek tjetra përmes Homerit, Virgjilit, Aligerit, Shekspirit, Apolinerit, gjermanëve, irlandezëve/Xhojsit etj., kujtesën e vullnetshme për ta institucionalizuar në rrafshin akademik prestigjioz kërkimor të Harvardit, duke e trajtësuar në një "epevent të ri", (dedikuar dy studiuesve)[7] ndoshta i fundit në globin tokësor, që prodhonte ende një lëndë të tillë poetike si ajo e Homerit; ishin shkëndijat e fundit të flakës së dikurshme. "*Këndo o muzë, zemërimin e* Harvardit, e International Center of Homeric Resaerches (f. 57).

Jo rastësisht vargu i parë i Ciklit të Kreshnikëve kujtohet e ndërfutet tri herë në rrëfim si një formulë e përhershme: "*Shum' po shndrit nj'ai diell e pak po nxeh*" duke risjellë klishenë e eposit tonë, të një prej epëve të vjetra që gjendet "në të gjitha antologjitë e leximit letrar", siç përsëriste me vete Dezi, si dhe procesin e "homerizimit" të ngjarjeve, materialin e gjallë jetësor që hyn në makinën e eposit, por duke u bërë bashkëshoqërues e lajtmotiv metaforik i hulumtimeve të studiuesve në dritësimin e enigmës homerike. Vullneti për të cituar në greqisht dhe në shqip vargun e parë të *Iliadës*: "*Menin* aeide thes Peleiadeos Ahilaios/ *Mëninë* këndo hyjneshë të Akil Peleut," grish e provokon te studiuesit e huaj argumente për të motivuar, që me vargun e parë të kryeveprës homerike e në vijim, truallin e përbashkët greko-ilir. (*Dosja*, f. 106)

Përmes autorësh të antikitetit greko-latin (Homeri, Vrigjili, e personazheve njerëzorë e hyjnorë të veprave të tyre Priami, Helena, Menelau, Akili, Agamemnoni, Penelopa, Patrokli, Laokonti, Zeusi etj.) te *Përbindëshi,* referenca nga kënga IV e Odisesë: "Në kalin e drunjtë ne prijësit rrinim strukur/ kur ti erdhe Helenë..." (f. 37), si dhe vargjet: "Përse i le gërmadhat e Ilionit, ç'kërkon/ që midis kohërave të tjera endesh si/ somnambul? /

S'të mjaftuan zjarret, tempujt, klithmat e Trojës?/ Përbindësh! Me mish qytetesh u mësove (f. 81) vijnë si dilemë kujtese; nëse vargjet ishin lexuar diku apo ishin krijuar vetvetiu "si shtresa e myshkut në faqen e një muri?". E këtu, kujtesa, kujtesa kreative, lejon që teksti letrar të evokojë etërit, jehona e të cilëve nuk vjen si *"tabula rasa*", por si rikrijim (shtresë myshku) që prish karakterin e mbyllur të veprës dhe e hap e gjallëron atë me polifoni zërash e jehonash të fshehura në thellësinë e kohës.

Mekanizmi i kujtesës kreative[8] te *Dosja H.*, nga njëra anë, provohet në terren nga regjistrimet e kohëpaskohëshme të rapsodëve, prej të cilave rezultonte se nga rreth një mijë vargje mungonin vetëm dy, kurse te skena e *Mujsit të lidhur*, vargu: "Shkrumb i pishës n'**mjekër** t'Mujsit nxinte", ishte bërë: "Shkrumb i **zi** pishës n'**jargë** përzihej"; pikërisht këtu qëndronte "thembra e Akilit" për çështjen homerike, studiuesit kishin kapur ingranazhin kryesor të mekanizmit të kujtesës, njësinë më të vogël të ndryshimit (të harresës), atë që ndodhte tek i njëjti lahutar brenda dy javësh për t'u shtuar (krijuar) me diçka të re, më pas (*Dosja H.,* 126); nga ana tjetër, te *Përbindëshi*, Kadareja i është rikthyer rrethimit të Trojës "që të shqyrtojë historinë e 'ta korrigjojë' atë në hapësirën e imagjinatës sonë"[9] duke mbështetur bindjen se rënia e Ilionit ishte një nga krimet e para të mëdha të njerëzimit. Nën optikën e kujtesë-harresës, mjegulluar në kaos, prej shekujsh, Gent Ruvina shihte qartë praninë e hijes së Kalit dhe në tezën e tij të doktoraturës shtronte çështjen nëse Kali i drunjtë: *së pari*, nuk ka ekzistuar fare; *së dyti*, ka ekzistuar diçka e ngjashme me të në parim, gjë që do të na drejtonte te zbërthimi i simbolit; dhe, *së treti*, Kali i drunjtë ka ekzistuar, por vetëm si mbulim për të vërtetën. E rëndësishme mbetet se Fantazma e Kalit ka ndjekur gjithherë njerëzinë, madje na ndjek edhe sot e kësaj dite, troku i tij ndjehet kudo (*Përbindëshi,* f. 36). Dyshimi i studiuesit mbështetet nga prania e një Furgoni të madh të braktisur, disa kilometra larg qytetit, pjesët metalike të të cilit "ia kishin *shkulur prej kohësh* dhe tani s'i kishte mbetur veç karroceria *e mbyllur prej druri*".[10] Rapsodia e Zukut Flamurtar: "Un', do t'marr, eh, sot një gjak të vjetër./ Kurr' ksi gjaku kujt s'i ra me marrë" (f. 122), nyjëton kujtesën cituese të vullnetshme me kujtesën orale, si dhe evokon shtresa të thella të antikitetit grek. Jo më kot, gjermanët e kishin cilësuar "Orestiada" shqiptare, aty gjendeshin të gjitha "si dikur: edhe tradhtia e së ëmës së Zukut, edhe motra që e shtyn vëllanë në mëmëvrasje, edhe furitë edhe ndëshkimi" (f. 122).

Epika orale ka qenë dhe mbetet art i veshit, struktura ritmike e këngëve popullore lehtëson memorizimin e tyre, ndërkohë që të kënduarit me instrument muzikor e përcillte ndër breza; *veshi* (të dëgjuarit) është shqisa, mekanizmi, institucioni i vetëm i kujtesës rapsodike, pa ia pasur nevojën *syrit* (të lexuarit), pa të cilin s'mund të kuptohet arti i sotëm: "Jo më kot Homeri ashtu edhe përfytyrohej, pa sy (*Dosja H.*, f. 138). Nëse shpikja e shkrimit përbën kufirin ndarës midis fazave të qytetërimit, për rapsodët, shkrimi përbënte një nga tragjeditë më të mëdha të njeriut, sepse pikërisht mendimin e tij të lirë e nguroste me prangat e shkronjave; për aedët ajo shpikje ishte shumëfish vrastare: "E kishin më të lehtë të mendonin fundin e botës sesa këngët e tyre të ngulura në pllaka, të kryqëzuara me kanxhat e shkronjave, si të dënuarit me vdekje" (*Përbindëshi*, f. 44). Kujtesa e veshit është sipërane ndaj asaj të syrit të nënprefektit (kujtesë administrative, mekanike dhe e ngurtë), i cili nuk i shton e nuk i heq asgjë raporteve të përgjuesit. Kështu, *Dosja H.* dukshëm është rrëfim për kujtesën kolektive, kujtesën e trashëguar, si një përmendore kushtuar monumentit të gjallë të epikës, që transmetohet prej rapsodëve. Rrëfimi bazohet në mekanizmin e kujtesës e të harresës si elemente themelore të eposit gojor, si një mekanizëm i gjallë e jetik që bartet e përcillet nga rapsodët, këta "*hamej* të këngës, gjersa një ditë të zhdukeshin, siç zhduken vërtet hamejtë prej konkurrimit të *makinave*" (*Dosja H.,* f. 147). Rrjeti ndërlidhës i marrëdhënieve tekstore *Dosja H./Përbindëshi* karakterizohet nga një tension ndërmjet lirisë së eposit popullor për të gjalluar në formën e vet

natyrale të pafiksuar nga njeriu dhe, nga ana tjetër, instalimit të diktatit te Kali i drunjtë/*Përbindëshi* që në kohë-hapësira të ndryshme ngurtësohet e sofistikohet në mjete moderne, të cilat shumëfishojnë dhunën dhe trysninë në shoqërinë njerëzore. Liria si thelb e funksion i artit popullor të cilën vështirë se gjendet *Dosje* ta përmbledhë, kryqëzohet me kontrollin e diktatin që ushtron *TotalKali* përmes ligjërimit që luan në kohë-hapësirën e kujtesë-harresës. Nëse *Dosja H.* është himn për lirinë e krijimit dhe qarkullin e vlerave njerëzore, *Përbindëshi*, përkundrazi, përfaqëson cenimin, kufizimin, ngurtësimin e lirisë në shoqëritë diktatoriale aq sa dhe angazhimin autorial për të rishkruar historinë.

Në të dyja veprat, kujtesa përmes harresa/ve (*Dosja H.*) dhe golleve/zbrazëtive (*Përbindëshi*), bëhet shenjë identiteti nacional; ajo është dinamike dhe e larmishme, nga njëri rapsod tek tjetri, mes motërzimesh të ndryshme te *Dosja H.* dhe konservuese, e patjetërsueshme, e ngrirë dhe e frikshme te *Përbindëshi*. Në rastin e eposit, harresa/t nuk është e kundërta me kujtesën/at, "gjoja harresa e gjoja shtesa", ato nuk kanë të bëjnë me mundësitë e kufizuara të kujtesës njerëzore, por janë pjesë përbërëse e laboratorit krijues popullor si "në procesin e metabolizmit të qenieve të gjalla, ajo është një vdekje që siguron vazhdimësinë e jetës" (*Dosja H.*, f. 135). Por, kujtesa *ngrin* për ngjarje



dhe data të rëndësishme historike, si për 1913-n, vitin e mbrapshtë të copëtimit të Shqipërisë, për të cilin eposi sikur nuk ishte gjallë, ai me shumë mund nxori 4–5 vargje, ndërkohë që do të duhej të sokëllinte, ose kur me zor prodhoi 12 vargje për Kongresin e Berlinit (*Dosja H.*). Këto ngjarje nuk këndoheshin, nuk epizoheshin, nuk homerizoheshin, nuk ishte e rëndësishme të kujtoheshin, pra më mirë të harroheshin. Epi dinte fort mirë çfarë të prodhonte e të memorizonte – çfarë i duhej kujtesës kolektive. Edhe Helena e *Përbindëshit* "ngrin" kur flitet për Kalin e Drunjtë; ajo gjithnjë sheh anët e këndshme e të bukura të ngjarjeve të vjetra, veç kur dëgjon për Kalin e Drunjtë, ajo ngrin e gjitha, siç është i ngrirë dhe ai vetë, sepse atje mbaron çdo dritë dhe nis terri e tmerri.

Rrëfimet për *Përbindëshin* dhe *Dosjen H.* ngërthejnë një rrjet të ngjeshur përkimesh e asocimesh; nga faqja e parë e librit e në vijim, receptuesi vë në diskutim aktin e leximit, fundin e faqes; ai penetron ngadalë te paraardhësit e tij bashkë me ndikimet e mundshme kulturore, duke ndërtuar një sërë marrëdhëniesh reciproke mikroskopike e makroskopike.

Eposi vdes në kohët moderne; regjistrimi në magnetofon, "në arkën ku mblidhet zëri i njeriut si litari në çikrik për ta lëshuar prapë" e ngurtëson memorien popullore. Magnetofoni përfaqëson kujtesën moderne, një "vegël ogurzezë" (*Dosja H.*, 177), harresën e eposit në gjendjen orale, harresën e plotë të tij, verbërinë e këngës popullore që futet në "sënduk të skëterrës", në një "arkëmort" e "kosë të mortjes", për t'u shndërruar në forma të kujtesës moderne. Rrethi vicioz i njëjtësimit: verbëri = kujtesë = kujtesë dëgjimore = kujtesë e veshit = epos-art popullor, si art i kënaqësisë së dëgjimit (Homeri kishte qenë i verbër, Demokrati u verbua me dashje, ngaqë sytë e pengonin të thellohej në përsiatjet e tij, për çudi edhe Vilit po i dobësohej gjithnjë e më shumë shikimi), është në presion e rrudhje të vazhdueshme me kujtesën e syrit (leximin dhe shkrimin) dhe me atë moderne, të shënuar nga aparatet përgjuese – që do të vijnë nga kryeqyteti, për të zëvendësuar përgjuesin/Dullë Buxhanë[11] dhe nga magnetofoni i irlandezëve. Autonominë dhe lirinë e epit dhe të kujtesës popullore në gjendje të lirë, narratori e jep në analogji me "telat e shqyer dhe të këputur" të magnetofonit, që nuk mund të jenë tjetër, veçse gjallimi i epit përmes motërzimeve të shumta, e njëherësh pamundësia për ta mbledhur/regjistruar, si një trup/vepër të vetëm/e: "Ne u përpoqëm ta mbledhim atë, por… ai na u thërrmua, ja kështu si nga një katastrofë…".

Imazhi dhe vizioni artistik, që përftohen përmes kujtesës, përbëjnë një mekanizëm të ndërlikuar e njëherësh efikas, me anë të të cilit shkrimtarët modernë i kundërvihen epokës bashkëkohëse, thënë ndryshe, Ismail Kadare me *Dosjen H.* i ngre përmendore kujtesës kolektive, të kënduar në epikën tonë, në kundërvënie me epokën industriale, të ashpër e të shurdhët, që modifikon e "vdes" kujtesën dëgjimore; ndërkaq te *Përbindëshi*, si shënon É. Faye në parathënie, Kadareja kërkon "domethënien bashkëkohore të një 'monumenti' të famshëm të kujtesës kolektive botërore",[12] forcën e shoqërive të diktatit për të ndërtuar qysh në embrion mekanizmin e vetëfunksionimit, shtypjen e dhunën me rrezatim horizontal e vertikal, që ushtron trysni në shoqëritë njerëzore.

Tensioni artistik mes kujtesës së përmendores së trashëgimisë sonë të përbashkët orale dhe bindjes së gjallimit të saj në gjendje natyrale e të lirë, të një *Dosjeje H.*..., që kurrë nuk do të mund të përfshinte/ndriçonte gjithçka, kundrejt makinerisë së frikës dhe dhunës së *Përbindëshit* ndërkallur në një rrejt të ngjeshur imazhesh-simbolesh: Kalë, TotalKalë, Furgon, Përbindësh, Muze, Muri Kinez; Dosje, Magnetofon, Shtjefni, Bujtina "Rrashti i Buallit" etj.); kohëra të largëta që rivijnë e përmbysen te ne për të dëshmuar forcën e antikitetit, si gjiganti që shtreson palë-palë në supe kohërat. Kujtesa e oralitetit "si rishfaqja e qenieve në metempsikozë" (*Dosja H.,* f. 59), me të cilën lidhen të dyja veprat, trajtëson alegorinë e shpëtimit në diktaturë, të shpëtimit të trashëgimisë sonë kulturore identitare nacionale përmes artit të fjalës.



John Updike

RËNDËSIA E SHKRIMËSISË

E po, kur të duhet të shpallësh rëndësinë e diçkaje, kjo mund të nënkuptoj se ajo nuk është edhe aq e rëndësishme. Dhe sigurisht që shumica e njerëzve në Shtetet e Bashkuara vijojnë jetën pa lexuar letërsi artistike, dhe gjithnjë e më shumë revistat po botohen pa e pasur atë pjesë të saj. Organeve të hershme letrare që nuk reshtin së botuari letërsi artistike duhet t'u jemi mirënjohës, dhe u jemi. Nuk ishte e lehtë ta besoje se ky biznes kaq i brishtë do t'ia dilte të mbijetonte, por ia doli.

Në gjimnazin e Gutenbergut, në Erfurt të Gjermanisë, Dikensi dhe Balzaku studiohen me hollësi dhe motrat Brontë u rikthyen tek praktika e autores së "Kasollja e xha Tomit", Harriet Beecher Stow, me volum shumë më të trashë se romanet e Herman Melville-it, ndërsa Gustav Flaubert dhe Mark Twain shkaktuan një trazim të dyfishtë krahas njëri-tjetrit duke e tronditur borgjezinë. Edhe në ditët e mbizotërimit të radiove, proza letrare e bënte më leshtor gjoksin e Hemingway-t, hidhte xhin në gotën e Fitzgerald-it dhe e shihte me vështrim largpamës Faulkner-in, edhe kur nuk u grahej më mushkave.

Por pasi kryqi i thyer i Hitlerit u gozhdua në derën e hangarëve dhe burrat u kthyen nga lufta dhe për të veshur triko bojë hiri dhe për t'u bërë me fëmijë, diçka u formësua tek proza letrare. Ata njerëz të mirë që uleshin afër sobës me dru në kuzhinë duke lexuar në revistën "Saturday Evening Post" blenë furnela dhe televizorë. Aureola e festës që po mbaronte ishte aq e përhapur sa Norman Mailer-i u përpoq ta kremtonte festën vetëm fare. Saul Bellow vazhdoi të fitonte çmime letrare, por kishte diçka të stërholluar dhe ligjërimin e një profesori tek vepra e tij, krahasuar me mënyrën si Sinclair Lewis-i dhe John Steinbeck-u e shkundën jetën në qyteza dhe fshatra me qasje satirike, ndërsa librat u shiteshin për dy dollarë dhe i gjeje në dhomat e pritjes së mësuesve të pianos në çdo qytezë.

Vitet 1960-të ishin vitet kur vdekja e prozës letrare shihej si diçka për t'u mburrur. Philip Roth na tha që jeta në Amerikë ishte bërë kaq barbare dhe e çuditshme sa asnjë prozë s'mund të ndizte një qiri për të vërtetën groteske. Truman Capote arriti të shpikte një lloj të ri të kënaqësisë rrëfimtare, romanin jo-letrar, që e bëri prozën që s'kishte para një –jo të dukej aq e hershme sa akullorja që bëhej me dorë. Tom Wolfe (i riu) na tregoi në mënyrë të pashmangshme se gazetaria e re ishte më energjike, gllabësurese, argëtuese dhe më e egër, se sa çdo prozë e mëparshme e mprehtë, e botuar nga gjigantët e vegjël të New Yorker-it. Edhe tek New Yorker-i, pasi u zhdukën rubrikat e dikurshme për letërsinë dhe u zëvendësuan nga ato të specialistëve të gjithëditur, kishte më pak hapësirë për letërsinë artistike.

Revolucioni pak i hyri në punë prozës letrare: ajo ishte lartësim, sikur tek F.R Leavis-i dhe Lionel Trilling-u, kishin statusin e shkollës pasuniversitare, ishin civilizimi dhe pakënaqësitë e tij, ishin turmë e vetmuar. Shkrimësi ishte ajo që rrëfente se si e kishe ngushëlluar veten në epokat e errëta para rruazave të dashurisë së Beatles në këngën "Lusi në qiell me diamante". Një revolucion këndon këngë dhe shkërmoq xhamat e dyqaneve, i bën gjërat në zgrip dhe asgjë s'është më izoluese nga familja dhe më antishoqërore se sa individ i ulur në një dhomë të qetë duke koduar krijimin për një individ tjetër i cili e deshifron në një dhomë të qetë mbase dhjetëra vjet më vonë dhe mijëra milje larg.

Në përputhje me rrethanat, revolucioni na la muzikën rock dhe konviktet e përbashkëta por jo shumë në mënyrën si u shkrua proza letrare. Kush e kujton tani "Vallëzimi i shqiponjës" (1970) së Marge Piercy-t dhe "Udhëtimi Hyjnor" (1971) i Gurney Norman-it? Mua më kujtohen vetëm ngaqë kam shkruar për to. Ishin Thomas Pynchon-i dhe Ken Kesey, ata të cilët u prirën të shkruajnë duke bërë pyetje por pa dhënë përgjigje. Pika kulmore e përmbysur pas-revolucionare, nuk mungoi për bardët, duke filluar me Ann Beattie-in, e cila gjeti tonin e duhur të filtruar për të reflektuar mungesën e dritës, dhe megjithëse e re, luajti roline e nënës së munguar për shumë vajza dhe gra të reja dhe të talentuara. Krijuesit e rinj burra s'janë aq të gjallë, sepse pasi kanë debutuar, priren t'u kushtohen punëve jashtë-letrare ose të shmangen drejt Hollywood-it. Por, megjithatë brezat i shijojnë mundësitë e mëdha të prozave të tyre njëlloj si të klasikëve.

Shkrimësia s'është asgjë më pak se instrumenti më i mprehtë i vetë-diagnostikimit dhe shfaqjes së vetes që njerëzimi ka shpikur. Psikologjia dhe rrezet X hedhin dritë në zona të errëta, ndërsa fotografia që përkap objektin duke bërë dhjetëra lëvizje brenda sekondës, e zbërthen në mënyrë të shkëlqyer, për të dhënë spektrin e e plotë të qenies njerëzore, por askush tjetër përpos letërsisë artistike nuk mund ta jap të paqartën, aktualitetin, ajrin, hekurin, zjarrin dhe pështymën e aventurës tonë të përditshme prej vdektarësh. Kjo e bën sociologjinë puritane, historinë problematike, kinemanë dy-përmasore dhe gazetën "National Enquirer" po aq pa kuptim sa qeska me misra e javës së kaluar.



Në prozën letrare, çdo gjë që kërkuesit e të rëndësishmes priren ta lënë jashtë përfshihet, dhe ajo që ata do ta kishin përfshirë lihet jashtë. Stendali shërbeu me përkushtim gjatë periudhës së Napoleonit dhe ishte një nga mendimtarët më të kthjellët në Evropë, por ajo që Fabricio thotë për Vaterlonë tek "Manastiri i Parmës", është thjesht çoroditëse, gjë që ai e thekson në bisedë e sipër me zonjën e një pijetore e cila manovronte mes telasheve të përditshme që nxirrte beteja me shportat plot me shishe konjaku.

Për Tolstoin, Napoleoni ishte arsye shfajësuese që aristokratët e Moskës të bënin thashetheme dhe të vijonin me kërkimet e tyre shpirtërore. Për Jane Austen-in, Napoleoni ishte arsyeja pse në fshatrat angleze ishte kaq e vështirë të gjeje një burrë për t'u martuar. Kështu, prania e madhe historike përthyhet në jetë të vogla të cilat janë të çmuara vetëm sepse ngjasojnë me jetën tonë. Kutuzovi, të cilin Tolstoi e krijoi si versioni të trilluar shkëlqyeshëm të një gjenerali të vërtetë rus, lexon romancat franceze ndërsa stepat përreth tij dridhen kur afrohet mbinjeriu, mjeshtri i strategjisë, gjenerali me aftësi gjeniale. Historitë e shkruara ruajnë ndjenjat njerëzore ndër baticat e pakontrollueshme të historisë, jetën e brendshme të errësirës, siç vë në dukje Erich Auerbach tek "Mimesis",duke nisur që nga Testamenti i Ri, ruajnë barrën e veçantë dhe të çmuar të imagjinatës rrëfimore perëndimore.

Shkrimtari i prozës letrare është avokati i popullit që mbron çështjen tonë modest, të dyshimtë në sallën ku mbahet procesverbali i përjetshëm.

A janë murmurimat e ngatërruara dhe të guximshme, ditët gjatë të cilave mbledhim humbjet tona të vogla dhe dashurinë e lodhur, të kompromettuar, kutërbuese martesore pjesë e ekzistencës sonë? Atëherë vendosini ato në letërsi së bashku me Homerin, thotë Uliksi. A ka kaluar një jetë e harxhuar kot së koti me snobizëm, mosveprim, kriza nervash dhe dhimbje në zemër? Atëherë, shndërroje këtë jetë në një katedrale fjalësh, thotë Proust-i me "Në kërkim të kohës së humbur".

A shkruhet çdo ditë në gazeta për vrasje patetike dhe pa kuptim? Atëherë tregoni aspiratat tuaja të përulura, qëllimet e mira dhe gabimet e vogla që çojnë në mënyrë të pashpjegueshme në një shkatërrim të tillë, na tregojnë "Tesi i D'Ebervilëve" dhe "Një tragjedi amerikane". Ndjeheni nervoz sikur gjërat nuk përputhem mjaftueshëm? Atëherë shkruani si Virginia Woolf dhe na jep aktualitetin me shfaqjet e panumurta rrëshqitëse dhe përndritëse. A ndihesh më shumë se nervoz, dhe i sigurt që bota është rrëmujë? Atëherë shkruaj si Céline dhe zgjo gjuhën frënge. Dëshironi të provosh shijen e melankolisë së vendeve egërshane të Amerikës Latine? Provoni Graham Greene-in ose Gabriel García Márquez-in. Doni të dini se çfarë ndodh në ato zhvillime të vështira shoqërore përgjatë autostradës? Lërini t'jua tregojë Raymond Carver-i ose Bobbie Ann Mason-i. A jeni kureshtarë për jetën në godinat me bashkëpronësi thëllë në Jugun e ri, të homogjenizuar? Ja ku kemi Frederick Barthelme-in.



Asnjë frymë njeriu apo vendas nuk është me tepri i përvuajtur sa të jetë vend i trillluar argëtues dhe edukues. Në të vërtetë, të gjitha gjërat e tjera janë të barabarta, të pasurit dhe magjepsësit janë më pak tokë pjellore se të varfërit dhe të zakonshmit, dhe qoshet e pista të botës ngallin shumë më shumë interes se sa qendrat vezulluese, tashmë të reklamuara sa duhet.

Megjithatë, ne nuk lexojmë prozë letrare për informacion, edhe pse mund të jetë informuese. Për dallim nga gazetaria, historia ose sociologjia, ajo nuk na jep fakte të mbërthyera në të vërtetën e tyre të njohur, për t'u pranuar dhe përvetësuar si pilula, për të mirën tonë të padyshimtë; ne e bëjmë prozën letrare të ngjaj e vërtetë ndërsa e lexojmë. Krijimet letrare mund të na e trazojnë fort mendjen, ashtu siç kanë bërë "Zonja Bovari" dhe "Don Kishoti". Ato rreken të zgjerojnë ndjenjën tonë të mundësive, të lirisë së mundshme, dhe liria është e rrezikshme. Bota kapitaliste, në krahasim me hierarkitë mesjetare dhe ato komuniste, është rrezikshme, sepse dështimi mund të jetë absolut dhe suksesi mund të jetë jetëshkurtër.

Romani dhe tregimi i shkurtër u ngritën bashkë me borgjezinë, si ushtrim i ndjenjës demokratike dhe si aventura individuale. "Pamela", e Samuel Richardson-it, "Përparimi i pelegrinëve" e John Bunyan-it, dhe "Robinson Crusoe" i Daniel Defoe-s, a s'na thonë gjë tjetër pos faktit se sipërmarrja jonë, në një nivel ose në një tjetër, mund të ketë sukses?

Nëse shkrimësia është në rënie, kjo ndodh sepse kemi humbur besimin në aftësinë e individit për të ecur përpara me kurajo dhe të vuajmë pasojat e ëndrrave të tij. Unë vetë mendoj se kjo formë artistike e cila është më elastikja dhe e fuqishmja sërish mbart hapësirën e saj të pamasë për imagjinatat tona, prapë i përgjigjet një shprese brenda nesh për më shumë aventura. Në fund të fundit çfarë paska më të rëndësishme se individi? Dhe ku mund të përballet, vlerësohet dhe shijohet individualiteti më mirë se sa tek gënjeshtrat e trilluara kaq hijshëm të letërsisë artistike?

Përktheu Granit Zela

LOJA E PAFUNDME

LOJA E PAFUNDME
LOJA E PAFUNDME
LOJA E PAFUNDME

SIMON SINEK

LOJA E PAFUNDME
LOJA E PAFUNDME
LOJA E PAFUNDME
LOJA E PAFUNDME

AUTORI BESTSELLER I
FILLONI ME PSE
DHE
LIDERËT HANË TË FUNDIT

Minerva